

Edith Pierpont Stickney  
Sacramento Junior College  
Ish instruktore e Historisë në Kolegjin Goucher

# SHQIPËRIA JUGORE

ose

## EPIRI I VERIUT

në

### Çështjet Europiane Ndërkombëtare

*1912 - 1923*

---

Universiteti Standford, Kaliforni - USA  
Shtëpia Botuese "KOHA" - Tiranë, 1998

**Edith Pierpont Stickney**

*Sacramento Junior College  
Ish instruktore e Historisë në Kolegjin Goucher*

*Shqipëria Jugore ose Epiri  
i Veriut në Çështjet  
Europiane Ndërkombëtare  
1912 - 1923*

---

Përktheu nga origjinali:  
**Mal Berisha**

---

**Universiteti Stanford, Kaliforni**

Titulli i origjinalit:

**Southern Albania or Northern Epirus  
in European International Affairs  
1912 - 1923**

Copyright 1926 By  
**Standford University Press**

*All rights reserved*

Published, December 1926  
In the United States of America

Përktheu nga origjinali:  
**Mal Berisha**  
*Stamboll, Gusht 1997*

Ribotimi:  
**Shtëpia Botuese "KOHA"**  
*Prill 1998*

Recenzent: **Mero Baze**  
Redaktor: **Enver Bytyçi**  
Korektor: **Izet Duraku**  
Në kompjuter: **Elvis Themeli**  
**Enkela Sheqeri**

## Parathënie

Ndërkohë që Lufta e Madhe po shkonte drejt mbarimit të saj, u bë e qartë se midis problemeve më ngulmuese, më të rëndësishme dhe më të vështira me të cilat do të ndeshesh Konferenca e Paqes që po afrohej, ishin problemet e kombësive që përfshinin kërkesat e popujve të pakënaqur ndaj sundimeve dhe që kërkonin ose pavarësi ose bashkim me racat e tyre të afërta. Vetëvendosja e popujve, e shpallur prej aleatëve si njëri ndër qëllimet kryesore të luftës, hasi në një përgjigje të menjëhershme. Këto çështje ishin të gjitha probleme që shqetësonin popujt. E parë nga një pikë tjetër vështrimi, ato u përqendruan rreth zotërimit të territoreve, pra ishin ngatërresa kufijsh. Midis këtyre problemeve, çështja e Shqipërisë Jugore ose e Epirit të Veriut ishte njëra nga më të debatuarat ndër zonat që rrezikonin paqen në Europë e që përbëhej sa nga kërkesa rivalesh nacionaliste po aq edhe nga interesa të disa Fuqive të Mëdha.

Kjo ese synon të bëjë një studim të gjithanshëm e të plotë të historisë në fjalë nga viti 1912, kohë kur kjo çështje fillon e merr njëfarë rëndësie diplomatike

e deri në vitin 1923, duke e vënë theksin pikërisht tek aspektet më të gjëra europiane por edhe tek ato elemente lokale e kombëtare të cilët ndikonin në situatën ndërkombëtare.

Shumë material i vlefshëm në arkivat qeveritare është ende i pa publikuar dhe padyshim do të jetë për një kohë të gjatë i papublikuar dhe i pakapshëm. por praktikisht të gjitha materialet e shtypura janë në Biblotekën e Luftës, Hoover në Universitetin e Standfordit, i cili zotëron ndoshta koleksionin më të plotë të materialit rreth kësaj çështjeje, një pjesë e mirë e të cilës është përdorur pikërisht në këtë studim.

Kjo ese është paraqitur në fillim si tezë për shkallën e doktorit në filozofi në Universitetin e Standfordit. Subjekti i saj është sygjëruar prej Dr.E.D.Adams, pa ndihmën dhe drejtimin e të cilit zor se mund të ishte shkruhej. Praktikisht i gjithë materiali ishte në koleksionin e papërdorshëm të Biblotekës së Luftës Hoover në Universitetin e Stanfordit. Ndaj drejtorëve të asaj biblioteke e veçanërisht ndaj bibliotekares Miss. Nina Almond dhe ndaj Mr.Robert C.Binkley, referent i bibliotekës, autorja është mirënjohës për ndihmën e pakursyer që ata i kanë dhënë. Mirënjohje e thellë i dedikohet gjithashtu

dr.Percy A.Martin dhe Dr.Frank A.Golder të Universitetit të Standfordit për kritikën e plotë të dorëshkrimeve. Po kështu vlerësime të sinqerta për ish kolegen time në kolegjin Goucher, Dr.Mary E.Ëiliams, pa inkurajimin e së cilës kjo ese ndoshta nuk do të kishte çmimit "George Beer", të cilin Shoqata e Historianëve Ameriakne e dha në mbledhjen e saj në Ann Arbor me 1925. Falenderime të të veçanta shkojnë në adresë të Dr. Charles Seymor të Universitetit Yale, i cili ndihmoi me materialet që kanë të bëjnë me komisionin e çështjeve greke në Konferencën e Paqes, sikundër shihet edhe në bibliografi dhe në shtojcë.

Kësaj liste tashmë të gjatë të mirnjohjeve duhet t'i shtohet një fjalë vlerësimi për frymëzimin që autorja mori prej kolegjit Vassar nga ish mësuesit e saj atje, Miss Lucy M.Salmon, Miss Eloise Ellery dhe Miss. Dorothy Stimson, më vonë kolege të nderuar dhe miq në kolegjin Goucher. Falenderime të veçanta gjithashtu për kolegjin Vassar për dhënien autores të dekoratës Sutro Felloëship për vitet 1923-'24, i cili bëri të mundur përfundimin e veprës.

*Edith P.Stickney*  
*1 Dhjetor 1926*

## SHQIPERIA JUGORE OSE EPIRI I VERIUT NE ÇESHTJEN NDERKOMBETARE EVROPIANE GJATE VITEVE 1912-1923

### *1. Hyrje*

Krahina, e cila njihet si “Epiri i Veriut” prej grekëve dhe mbështetësve të tyre dhe si “Shqipëria Jugore” prej shqiptarëve, italianëve dhe përkrahësve të tyre, nuk mund të jetë plotësisht e përcaktuar, përderisa kufijtë e saj të paraqitur prej këtyre pretendentëve ndryshojnë bashkë me ndryshimin e situatës ndërkombëtare. Në një përcaktim të përgjithshëm, bazuar në kufijtë e vendosur në vitin 1913 në Konferencën e Ambasadorëve, ajo zë atë pjesë të Shqipërisë që fillon në Jug të Vlorës që shtrihet drejt lindjes deri në Korçë. Kjo pjesë zë një të katërtën e Shqipërisë me një sipërfaqe me rreth dymijë e pesqind deri në tremijë milje katrore<sup>1</sup>, pak gjë më e

*1. Nuk është bërë ndonjë shqyrtim territorial i përpiktë i Shqipërisë. Vlerësimet lëvizin nga 10.500 në 11.500 milje katrore. Albania, Peace Handbook Nr.17, faqe 1.*

madhe se sipërfaqja e shtetit të Delaweres në SHBA ose sa një e treta e tërë sipërfaqes së Greqisë. Sipas statistikave zyrtare të qeverisë greke, Epiri i Veriut përcaktohet të jetë zona që zihet prej Korçës, Gjirokastrës dhe një pjese të Janinës ose e thënë ndryshe, kazatë<sup>2</sup> e Korçës, Starovës, Kolonjës, Gjirokastrës, Himarës, Delvinës. Leskovikut, Tepelenës, Përmetit, Pogonit dhe Filatit dhe vlerësohet të ketë një popullsi prej 228.000 banorësh<sup>3</sup>.

Shqipëria Jugore zë një pozitë gjeografike të rëndësishme për arsye se ajo ndodhet përballë cepit lindor të çizmes italiane, pikërisht në pikën më të ngushtë të Detit Adriatik, prej ku kontrollohen tërë hyrjet dhe daljet në këtë det. Pozicioni i volitshëm, si ai që gëzon Shqipëria si një e tërë, dota bënte atë prej natyre një vend me rëndësi prej nga hyhet e dilet në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit perëndimor. I vetmi gji është ai i Sarandës dhe bregdeti përgjithësisht është i ashpër dhe ka pak shtigje për të hyrë në pjesët e brendshme të

2. Perandoria Turke ishte e ndarë për qëllime administrative në vilajete ose provinca të cilat kishin nënndarjet e tyre në sanxhake, dhe këto në kaza ose kantone dhe kazate vetë në nahije ose komuna.

3. Shtabi i madh i përgjithshëm helen. Carte ethnographique de l'Épire du Nord en 1913, faqe 2

krahinës<sup>4</sup>. Mungesa e gjireve dhe vështirësitë për të zbatuar në tokë e karakterizojnë atë si zonë të rrezikshme bregdetare. Pjesa e brendshme është malore. Lartësitë zgjaten nga veriu në jug duke i dhënë mundësi komunikimit në këtë drejtim por duke e vështirësuar atë në drejtimin perëndim - lindje<sup>5</sup>. Rrugët natyrore përshkojnë lugiant e lumenjve ndër të cilat, Vjosa është më e rëndësishmja, që ka si degë të saj, ato që krijojnë lugina pjellore të Gjirokastrës dhe Përmetit. Rrugët për karroca në këto lugina afrojnë të vetmen mundësi për transport. Rruga kryesore e lidh këtë rajon të brendshëm me Vlorën, Janinën dhe nëpërmjet të Korçës edhe me Manastirin e Selanikun.

Raca dhe gjuha e banorëve të Shqipërisë kanë qënë për shumë kohë subjekt i shumë spekulimeve, por i pak studimeve serioze. Megjithatë kërkimet e fundit kanë treguar se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve të lashtë, pra të një populli indo-europian ose arian, që flisnin një gjuhë që nuk rrjedh prej asaj greke, por që afrohet me greqishten sa dhe latinishten, ose që gjendet midis të dyjave<sup>6</sup>. Ajo ka huajtur një

4. Newbegin, Aspekte gjeografie të problemeve Ballkanike f/64.

5. Lyde- Ferryman, Gadishulli i Ballkanit, f. 109.

6. Thumb, Greqia moderne dhe antikiteti i saj f.10; Dixon, Historia racore e njeriut, f.95.

përqindje të mirë në fjalorin e vet të kufizuar<sup>7</sup> edhe prej grekëve edhe prej sllavëve<sup>8</sup>. Hulumtimet e fundit kanë treguar se shqiptarët janë më të gjatë se sa grekët, por më të shkurtër se boshnjakët; lartësia e tyre mesatare është 167 cm; midis të gjithë banorëve ballkanas ata janë më së shumti

Brachycephalic<sup>9</sup> me një indeks prej 86. Në përgjithësi ata kanë flokë dhe sy të zinj<sup>10</sup>.

Sikundër edhe në zona të tjera të diskutueshme të lindjes së Afërt, ku kufijtë etnografikë janë të vështirë për t'u përshkruar, popujt e këtij rajoni janë prej kulturash, besimesh fetare dhe gjuhësh të përziera. Askund tjetër në Evropë kriteri i gjuhës së folur nuk është aq i gabuar sa në kushtet ballkanike. "Një vëzhgues që simpatizon shqiptarët dhe që i mbështet vlerësimet e tij vetëm tek gjuha, mund të përshkojë të tërë vendin e të mos gjejë askënd tjetër përveç shqiptarëve, në një kohë kur një vëzhgues me prirje greke, duke proceduar në të njëjtën mënyrë nuk gjen

7. Rreth 5.000 fjalë. Shënime gjeografike mbi Ballkanin, f.16.

8. Huazimet e shqipes nga greqishtja, fjalë që i takojnë shtratit të vjetër të gjuhës së saj sipas Thumb "Altgriechische Elemente des Albanieesischen, "Indio Germanische Forschungen Zeitschrift, XXXVI, 11

9. Pikpamja më e vjetër dhe më e kundërt është shprehur në Ripley, *Racat e Europës*, f.409

10. Pittard, *popujt e Ballkanit*, f.81 -84

askërkënd tjetër përveç grekëve"<sup>11</sup>. Me fjalë të tjera, popullsia është përdoruese e dy gjuhëve, por gratë dhe fëmijët dinë vetëm shqipen. Kristianët e këtij rajoni, të quajtur toskë, i takojnë kishës ortodokse greke, ku gjuha greke është gjuhë e përdorimit dhe e mësimit. Klasat e larta, në përgjithësi, pa dallim feje, myslimane apo kristiane, flasin greqishten, e cila, të paktën në kohën kur kemi filluar këtë studim, ishte gjuha e kulturës dhe e tregtisë. Ndonëse është e vërtetë se popullsia i takon kishave të ndryshme, lufta fetare është shumë më pak e ndjeshme në Shqipërinë jugore se sa në veri. Myslimanët këtu tregojnë më pak fanatizëm ndaj kristianëve se sa në ndonjë vend tjetër edhe për arsyen se ata janë vetë pasardhës të ish kristianëve, të cilët u kthyen në islam me forcë. Për më tepër, në kushtet e rritjes së lëvizjes kombëtare edhe vetë kristianët ortodoksë shqiptarë kanë arritur të kuptojnë se feja e tyre është shfrytëzuar prej kishës greke për qëllime politike dhe se nuk kanë pse të tremben prej myslimanëve.<sup>12</sup>

E parë nga pikpamja ekonomike, Shqipëria jugore, më pak e prapambetur se sa ajo veriore, është një

11. Young, në *Revista bashkëkohore*, CXV, 498.

Woods, *Djepi i luftës*, f.161

12. Woods, *Djepi i Luftës*, f.161

vend bujqësor dhe blektoral. Pronarët e vegjël kultivojnë më së shumti misrin, ndërsa pronarët e mëdhenj dhe bejlerët kultivojnë grurin.. Mbas drithërave vijnë ullinj të si prodhimi më i rëndësishëm.

Duhani kultivohet në krahina të caktuara dhe më së shumti në Berat e Tepelenë. Malet janë të përshtatshme si kullota për gjedhe dhe dele. Blegtoria zë më shumë krahë pune se çdo punë tjetër<sup>13</sup>. Pyjet janë të paprekura, ndërsa mineralet, të cilat mendohet të jenë me bollëk, janë të pashfrytëzuara. Vendi është mbajtur në një sistem mesjetar, që haset edhe në vendet e tjera ballkanike. Beu, i cili e merr tokën prej sulltanit, rrallë e kultivon atë vetë por e jep tek qiramarrësit, prej të cilëve kërkon gjysmën ose një të tretën për vete, dhe një të dhjetën e merr si taksë për qeverinë<sup>14</sup>. Në rrethana të tilla fshatarëve shqiptarë u ofrohet shumë pak interes për të vënë energjitë e tyre në shërbim të prodhimit bujqësor. Kjo ka bërë që, sidomos popullsia kristiane, të ketë një arsye të fortë për të emigruar<sup>15</sup>. Mallrat që prodhohen në vend janë shumë pak dhe thuajse të gjitha konsumohen në

13. *Peace handbook No. 17, f.180-83; Markovich, Ekonomia ballkanike, f.53.*

14. *Po aty, No. 17. f.86.*

15. *Zhurnali helenik, Shtator, 2, 1917.*

tregun e brendshëm. Statistikat tregtare të dhëna nuk mund të përdoren vetëm për Shqipërinë jugore, pasi nuk ka të tilla; ato për Shqipërinë si një e tërë tregojnë se në vitin 1913, 55 përqind e mallrave që ajo importonte vinin nga Austro-Hungaria 25 përqind nga Italia dhe vetëm 5 përqind nga Greqia, ndërkohë që blerësi kryesor i mallrave shqiptare ishte Austro-Hungariae ndjekur prej Italisë<sup>16</sup>. Megjithatë për pjesën jugore pesha e Astro-Hungarisë ka qënë më e vogël, ndërsa ajo greke e pastaj italiane më e madhe.

Është e natyrshme të pyetet se çfarë roli ka luajtur karakteri ekonomik i krahinës në grindjet për kufirin. Pjelloria apo mirëqenia e kësaj zone është përdorur si një pretekst prej grekëve për realizimin e dëshirave të tyre eksapansioniste, të nisura që në kohërat kur ata e krijuan shtetin e tyre modern që kanë më shumë një bazë idealiste se sa materialiste. Nga ana tjetër po tu referohemi kërkesave të shqiptarëve, karakteri ekonomik i tyre është një faktor më i rëndësishëm. Përderisa Shqipëria jugore është pjesa më pjellore dhe me mirqënie më të lartë në tërë territorin e banuar prej shqiptarëve, dëshira për t'u përfshirë në shtetin e tyre shqiptar i ka rrënjët thellë në karakterin ekonomik të rajonit. Nuk mund të mohohet ngjyra

16. *Markovitch, veçer e cituar f.54.*

nacioanaliste që shfaqet edhe tek kërkesat e shqiptarëve, por nuk mund të mos shihet se Shqipëria jugore ka një vlerë shumë më të madhe ekonomike për Shqipërinë në tërësi se sa për Greqinë. Sa u takon vendeve të tjera, si Italia dhe Austro-Hungaria, karakteri ekonomik i interesave të tyre ndaj Shqipërisë është i pa konsiderueshëm dhe qëndron vetëm në interesa strategjike.

## II. Vështrimi historik deri më 1921

Një vlerësim i shkurtër i historisë së Shqipërisë Jugore përpara 1912-es është esencial për një kuptim adekuat të problemit gjatë periudhës së përshkruar në këtë ese. Vetëm nëpërmjet një studimi të tillë mund të kuptohet jo thjeshtë karakteri i banorëve dhe institucioneve të tyre sociale, por gjithashtu përplasja e interesave të fuqive të ndryshme të huaja. Për më tej, në pikpamje të referencave të shpeshta ndaj historisë së rajonit në literaturën propagandistike për çështjen në fjalë, një vlerësim adekuat i argumentave përfshin edhe kërkesën për një ide të mbështetur qartë në përvijimin e historisë së trazuar të këtij territori tejet të ngatërruar.

Në kohët antike emri Epir përdorej si një emër i përgjithshëm, që kishte kuptimin tokëe që, kishte antitezë, konceptin ishull, në rastin konkret ishullin përballë, Korfuzin (Corcyra). Por po të shohim kufijtë që përmendin shkrimtarët antike për të, atëherë del se Epiri shtrihej prej Glosa Promontorit në veri, deri tek gjiri i Artës në jug.<sup>1</sup> Ky

<sup>1</sup>-Wing. "Grindjet epirio-shqiptare për çështjen e kufinjëve në kohët antike" (Annual Report of the American Historical Association, 1919), 1.307.

rajon ishte më shumë i helenizuar, se sa pjesa tjetër në veri të lumit Vjosa.<sup>2</sup> Adhurimi i Zeusit këtu u paraqit tek Dodona Pellazge, që u bë i famshëm nëpërmjet fjalës greke: për tek ky orakull i nderuar grekët dërguan misione të shpeshta, dhe, falë mbrojtjes që iu bë këtij tempulli nga shkatërrimi i aetlianëve më 219 p.e.r, ai vazhdoi të ekzistojë deri në kohën e pausnianëve. Rrasat e gurta, në të cilat janë skalitur pyetjet që iu paraqiten orakullit, janë gjetur pranë Janinës ashtu sikundër dhe një teatër grek aty pranë<sup>3</sup>. Në kohët klasike greke Epiri ruante mardhënje jo shumë të afërta me pjesën tjetër të Helladës. Ne dëgjojmë veçanërisht për Admatius, i cili e mirëpriti Themistokliun e syrgjynosur dhe për Alcetasin, i cili u bë një vasal i Dionisit të Sirakuzes; me tej për martesën e Filipit të Maqedonisë me një princeshë epirote, e cila e bëri atë të ndikonte në fatin e vendit<sup>4</sup>. Në shekullin e tretë p.e.r (295-289) lufta e Pirros së Epirit kundër romakëve në Italinë Jugore i dha krahinës një rëndësi të përkohëshme. Sido që të ketë qenë puna në periudhat e mëpërparshme, Epiri në kohën e Pirros

2-Po aty, f. 313.

3. Gardiner, "Dodona", Enciklopedia Britanike, edicioni i njëmbëdhjetë;

4. Bury, Historia e Greqisë II, f. 239, 306-307.

ishte në përgjithësi i njohur si grek.<sup>5</sup>

Sundimi romak në fillim u shtri mbi Epirin e më pas mposhti Maqedoninë në betejën e Pydnes më 168 p.e.r. Udhëheqësi romak i asaj beteje, Aemilius Paulus, për të nënshtruar krahinën urdhëroi shkatërrimin e saj masiv, nga efektet e të cilit, Epiri nuk e mori veten kurrë. Sidoqoftë, atje më vonë u ndërtua një qytet i ri - qyteti Nikopolis - prej Oktavian Augustit për ndër të fitores së forcave të tij detare në Aktum. Nën Perandorinë Romake, Epiri dhe Shqipëria disa herë u bashkuan e disa herë u ndanë nga Maqedonia sipas nevojave të ngutshme administrative. Megjithatë vija ndarëse ishte më shumë politike se sa raciale apo gjuhësore. Justiniani ndërtoi shumë fortesa në Epir në përpjekjet e tij për të fortifikuar atë, por bregdeti mbetej prapë prapë një zonë plaçkitjesh prej ostrogotëve nën Totilën, i cili plaçkiti Nikopolisin dhe Dodonën. Gjatë periudhës antike vihet re një afëri raciale midis fiseve të jugut në vijën Glosa-Gramos dhe një dallim midis atyre dhe popullit ilir që shtrihej më në veri<sup>6</sup>.

Gjatë mesjetës, me përjashtim të disa periudhëve

5. Wing, vepër e cituar, f. 309.

6. Po aty, f. 320; Finlay, Historia e Greqisë I, f. 53. Bury, Perandoria e vonë Romake. I. XVII. 411; II, 24.

kohore, Epiri formonte pjesë të Perandorisë Romake të Lindjes ose të Bizantit. Ai u pushtua prej bullgarëve në shekullin e dhjetë dhe në shekujt e mëvonshëm prej normave, të cilët arritën të fusin këmbët atje përkohësisht nën Robert Guiskardin dhe djalin e tij Bohemond, por vetëm për katër vjet, sepse më pas do të binte nën sundimin e Perandorit Aleksandër Comnenus<sup>7</sup>. Me kapjen e Konstandinopulit prej kryqëzatave më 1204 dhe ndarjen e Perandorisë, Epiri i erdhi një rast për pavarësi dhe u formua kështu një principatë greke, Despotati i Epirit. Despoti Michael e sundoi me dorë të fortë vendin, i cili ishte i mbrojtur nga goditjet prej barrierave të tij malore dhe ndërkohë banohej prej një amalgame racash-sllave, vllahe, shqiptare dhe greke-secila prej tyre në një shkallë të ndryshme qytetërimi, dhe secila me synimin për të mbrojtur zakonet dhe institucionet e veta kundër fqinjëve dhe kundër princit. Përkundër një alenance të pasuksesshme me zotërit francëzë të Greqisë kundër Perandorit Grek, despotati vazhdonte të mbështeste pavarësinë e tij në një aleancë me princat latinë të Greqisë Jugore<sup>8</sup>.

7. Schevill, *Historia e Gadishullit të Ballkanit*, f.120. Oman, *Perandoria e Bizantit*, f.259-60. Finlay, *vepër e cituar*, IV, 28.

8. Finlay, *vepër e cituar*, f.304-308.

Më pak se një shekull më vonë, që nga viti 1350 luftrat civile në Epiri i paraprinë një pushtim të vendit prej serbit Stefan Dushan, i cili kapi kështjellën e Janinës. Pas këtij pushtimi, historia shënon përfshirjen në luftë të serbëve, shqiptarëve, frankëve dhe grekëve në provincat fqinje deri sa i tërë vendi ra nën dominimin e turqve në shekullin e pesëmbëdhjetë<sup>9</sup>. Por përpara se Shqipëria dhe Epiri t'i nënshtroheshin zgjedhës turke, një rezistencë historike iu bë asaj nga heroi i madh kombëtar shqiptar Skënderbeu, i cili për vite të tëra i mundi turqit nga fortesat e tij malore. Me vdekjen e tij më 1468, vdekje e cila e gjeti vendin thuajse në fund të burimeve të tij, Epiri ra në duart e venecianëve, zotërve të detit. Por Venediku, i vetëm në luftën kundër turqve, u gjet i pamundur që të rezistonte gjatë e kështu në vitin 1501 u detyrua që të njihte sovranitetin e sulltanit mbi bregdetin lindor të Adriatikut<sup>10</sup>.

Pushtimi turk u pasua nga një dyndje masive nga Shqipëria dhe Epiri drejt Italisë. Shumë prej elementëve më të mirë në të vërtetë mbushën

9. Finlay, *vepër e cituar*, IV, 129.

10. Brown, *epublika Veneciane*, f.96. Bouracrt, *L'Albanie et les Albanias*, f.106

*condottieret* e të gjitha shteteve të Europës<sup>11</sup>. Nën pushtimin turk shumë shqiptarë e pranuan islamin, ndërsa të tjerët mbetën kristianë. Shqipëria ishte në të vërtetë i vetmi vend ballkanik ku feja në këtë epokë, nuk nënkuptonte tërësisht edhe kombësinë<sup>12</sup>. Kjo situatë, shpesh herë e kaluar pa u vënë re, është e një rëndësie të posaçme për t'i kuptuar lëvizjet kombëtare të shekullit të nëntëmbëdhjetë në Ballkan. Fakti që grekët, serbët dhe bullgarët ishin kristianë, i ndihmonte ata në krijimin dhe ngritjen e ndërgjegjies së tyre kombëtare dhe ishte një lidhje që i bashkonte ata. Kjo lidhje u mungonte shqiptarëve, ngaqë ishin të ndarë në fe të ndryshme ose mbanin të njëjtën fe që mbanin edhe sundimtarët e tyre pushtues. "Atje ku shqiptarët ortodoksë dhe grekë jetonin së bashku, siç ishin ata në pjesën më të konsiderueshme të Epirit të Veriut, fati i përbashkët si kristianë i ekspozonte njëlloj ndaj taksave duke fshirë kështu dallimet e racave të cilave u përkisnin<sup>13</sup>.

Ajo që bie menjëherë në sy gjatë shekujve kur Shqipëria ishte tërësisht nën pushtimin turk është

11. Bourcart, vepër e cituar f.110. Iorga, *Historia e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar*, f.51. Shqipëria, 25 prill, 25 maj, 1918.

12. Bourcart, vepër e cituar, f.111.

13. Finaly, vepër e cituar, VI, 40

radha e pasuksesshme, kjo për shkak të përçarjeve, e përpjekjeve për të fituar lirinë. Duke zbatuar maksimumen *divide et impera*, përpjekja e turqve për t'i shtënë prijësit shqiptar kundër njëri tjetrit, çoi gati në një gjëndje fatale për vetë sundimin e tyre. Më i dalluari midis qeveritarëve të pavarur të shekullit të tetëmbëdhjetë ishte Ali Pashai i Janinës, i lindur në Tepelenë. Ambicioz për t'u bërë i pavarur nga sulltani, ai flirtoi me fuqi të ndryshme të Europës; një herë duke ndihmuar admiralin britanik, Nelson, që të fitonte betejën e Aboukir-it (1789) më pas, me rritjen e influencës franceze, duke kërkuar t'i hynte në zemër Napoleonit e kështu me radhë. Ai është veçanërisht i njohur për trajtimin mizor që iu bëri suliotëve kristiane ortodokse të Epirit, të cilët fituan admirimin e Bajronit. Ali Pasha ndihmoi sa në përsheptimin e revolucionit grek, nëpërmjet nxitjes që u bëri grekëve kundër sulltanit, aq edhe në tërheqjen e përqendruar të forcave kundër tij, duke i afruar paqëllimshëm rastin Greqisë që t'i jepte një grusht turqve në luftën e saj për liri. Në revolucionin grek, banorët e Shqipërisë jugore qenë shumë aktiv; disa iu bashkuan atij për arsye se Greqia ishte një komb i krishtere që luftonte kundër sulltanit; të tjerë, pasonjës të Ali Pashait, për të marr hak kundër armikut të përbashkët mbas rënjes së

udhëheqësit të tyre; dhe një pjesë tjetër për inat të Aliut nga trajtimi i pamëshirshëm që u kishte bërë suliotëve.

Por cilado qofshin arsyet e pjesmarrjes, roli i rëndësishëm që ata luajtën në luftën e Greqisë për pavarësi, është i dorës së parë<sup>14</sup>.

Duke shkuar drejt luftës për pavarësi, atëherë kur u mbajt Asambleja e katërt kombëtare greke, në korrik të viti 1829, deputetët u dërguan prej Epirit njësoj si edhe prej tokave të tjera greke, të cilat ende mbaheshin prej turqve<sup>15</sup>. Tashmë fuqitë e mëdha, Anglia, Franca dhe Rusia, të detyruara më në fund që të pranonin formimin e një mbretërie greke, në përpjekjen e tyre për të mbajtur aq sa të mundeshin status quo në dhe "integritetin" e perandorisë osmane, për shkak të interesave të tyre të rrezikuara, si dhe të xhelozive të ndërsjellta, lanë jashtë saj tërë Epirin si dhe Thesalinë e Kretën. Vënia e këtyre princave nën princin Leopold të Saxe-Coburg, kur atij iu afrua kurora greke, ishte e vetmja mënyrë e efektshme për pajtimin e Greqisë. Në të vërtetë që nga qeveria e parë helenike, Epiri përmendet qartë

14. Cherkezi, *Shqipëria, e kaluara dhe e tashmja*, f.39-40, 43-48.

15. Miller, *perandoria Osmane*, f.104.

si tokë greke<sup>16</sup>. Në Asamblenë kushtetuese të vitit 1843 delegatët nga Epiri ishin të lejuar të merrnin pjesë njësoj si ata që vinin nga territore të tjera të caktuara jashtë mbretërisë greke<sup>17</sup>. Parë në dritën e ngjarjeve të mëvonshme, del qartë se ndërtimi i një mbretërie më të gjërë në atë kohë, do të kishte sjellë tepër zhvillim dhe mirëqenie dhe irredentizmi nuk do të kishte luajtur rol aq të dukshëm në historinë mëvonshme të Greqisë.

Të përfshirë nga "megallos idea", prej së cilës rridhte ideja për restaurimin e Perandorisë Bizantine me anë të vendosjes së dominimit grek mbi rrënojat e Perandorisë Osmane dhe duke e besuar atë si një skemë të praktikueshme, burrat që e udhëhoqën Greqinë panë në Luftën e Krimesë një rast për të goditur Turqinë, meqë ajo i kishte duart e zëna diku tjetër, me qëllim që të aneksonin provincën aq të lakmuar të Thesalisë dhe të Epirit. Kjo skemë, e cila paraqiste avantazhe të qarta ndaj saj, ishte nxitur padyshim nga Rusia, e cila ndoshta bashkë me grekët, besonte se të gjithë ortodoksët që ishin nën sultanin, do të ngriheshin në rebelim, në momentin kur ca burra të armatosur do të kalonin kufirin nga

16. Sergeant, *Greqia në shekullin e nëntëmbëdhjetë*, f.218.

17. Miller, *vepër e cituar*, f.174

Greqia dhe do të shfaqnin flamurin e kryqit.

Por kjo aventurë greke s'ishte asgjë tjetër veçse një dështim. Ca mijra burra kapërcyen vijat kufitare dhe plaçkitën, çfarë u doli përpara banorët e Thesalisë e të Epirit, të cilët, si rrjedhojë kuptuan se ky keqtrajtim i bërë nga grekët nuk mund të pranohej prej turqve... Mbas katër muajsh, turqit i dhanë fund kësaj ndërhyrje invazionit dhe si pasojë, sundimi turk u forcua në këto dy provinca<sup>18</sup>.

Çështja e Epirit në fillim mori rëndësi të vërtetë europiane në Kongresin e Berlinit më 1878, në mbyllje të luftës ruso-turke. Gjatë luftës Greqia ishte akuzuar prej Turqisë për nxitje kryengritjesh në provincat otomane fqinjë. Në vitin 1877 lordi Derby me kërkesën e Turqisë i kërkoi qeverisë greke që ta autorizonte atë, të siguronte Portën se Greqia nuk do të godiste Turqinë ose do të bënte sikur nuk do t'i shihte përpjekjet për të nxitur kryengritjen në provincat greke. "Përgjigja e Greqisë ishte një zotim i kualifikuar, i kufizuar në kohën e "tashme" dhe një rrëshqitje e qartë për të "dekurajuar" kryengritjet"<sup>19</sup>. Opinioni publik grek kërkonte pushtime. Ministri grek M. Tricoupis deklaroi se ai mendonte se edhe

<sup>18</sup> Finlay, *vepër e cituar*, VII, 219, 223.

<sup>19</sup> Sergeant, *vepër e cituar*, f.276.

në se forca pushtuese greke do të mundej, kjo do të ishte më e mirë për Greqinë se sa të vazhdonte të përkrahte një qëndrim paqësor në luftë. Kabineti i ri grek shpalli më 2 shkurt 1878 se kishte vendosur që të pushtonte përkohësisht provincat greke në Turqi, por kjo nuk ndodhi pasi që njoftuar armëpushimi ruso-turk<sup>20</sup>.

Në kongresin e Berlinit, përfaqësuesi grek, M. Delyannis dhe M. Rhangale, paraqiten kërkesat për Thesalinë, Epirin dhe Kretën. Plotësimi i këtyre kërkesave, u tha atje, do të përmbushte dëshirat e popullatës së interesuar dhe do t'i jepte paqen mbretërisë. Përkundër premtimeve të njëmendta të Anglisë, se Greqia nuk do të ishte e humbur po të mbetej jashtë luftës, Lordi Salisbury, çmoi më shumë përfitimin e një vendi në Kongres, duke mos bërë asgjë për Greqinë.

I plotëfuqishmi francez, M. Waddington, nga ana tjetër, duke iu referuar faktit që Franca kishte qënë gjithnjë një lider kulturor në Lindjen e Afërt qysh në kohën e kryqëzatave, kërkonte t'ia bashkangjiste praktikisht Greqisë tërë Thesalinë dhe Epirin dhe në propozimet e tij ai kishte preferuar padyshim mbështetjen paraprake të italisë, Austro-Hungarisë

<sup>20</sup> Po aty, f.278,79.

dhe të Ruisë. Megjithatë këto propozime nuk morën miratimin e Lordit Beaconsfield. Kështu, duke njohur karakterin e pakënaqshëm të kufinjve të vitit 1831, ai kundërshtoi çdo përmirësim, bile edhe përfshirjen e rajoneve me përbërje të pastër greke me Turqinë jugore dhe deklaroi në mënyrë cinike se shtete si Greqia, të cilat kanë një të ardhme, janë në një pozitë të tillë që duhet të presin. Prandaj përballë kundërshtimit absolut të të plotfuqishmëve engleze, propozimet nuk ishin mbushamendëse dhe neni që merrej me çështjen e Epirit në Traktatin e Berlinit dha thjeshtë rekomandime për ratifikimin e kufijve<sup>21</sup>.

Kërkesat e Greqisë në lidhje me kufijtë e saj u lanë në hije, ndaj dhe nuk u gjend ndonjë formulim për to në Traktatin e Berlinit. Aq më tepër që qeveria konservatore e Britanisë së Madhe, e dëshiruar për të rivënë në vend influencën e saj të zbehur në Kostandinopol, kundërshtoi ushtronte presion për një zgjidhje të kënaqshme të problemit të kufijve greke. Kjo indiferencë e Lordit Salisbury i dha dorë Portës në rezistencën që e saj ndaj ndonjë korigjimi të kufijve greke dhe prandaj çështja mbeti e

21. *Sergeant, vepër e cituar f.286-87; Hansard, seria e tretë, CCXLII, 532-33, 564-65.*

pazgjidhur derisa Gladstone erdhi në fuqi në vitin 1880. Shpresat e mëdha të cilat u varën tek ai burrë shteti, të ngritura në zemrat e të gjithë kundërshtarëve të Turqisë, në rastin ekufijve greke u shkrehën tërësisht. Është e vërtetë se lordi Granville, i cili e mori në drejtim Foreign Officin, iu drejtoi një qarkore fuqive duke kërkuar bashkëpunim midis tyre për zbatimin e atyre kushteve të Traktatit të Berlinit të cilat ishin neglizhuar<sup>22</sup>, por kauza greke u dëmtua seriozisht prej situatës në Francë; përpjekje të bëra atje për të ndihmuar Greqinë ishin ndërprerë prej sekretarit të marrdhënieve me jashtë të politikës së jashtme franceze, më parë i predispozuar ndaj Greqisë, por tani i kthyer në drejtim të kundërt<sup>23</sup>. Për rrjedhojë, Porta, duke i gjetur Fuqitë të përçara, bëri një rezistencë më të vendosur, dhe nenet e Traktatit të Berlinit që trajtonin çështjen e Epirit mbetën thjesht në letër.

Në dy raste të tjera Greqia u përpoq të merrte Epirin: më 1885, kur u formua principata e Bullgarisë, të dyja, Greqia dhe Serbia, rivale të

22. *Schmidt, "Politika Britanike dhe Traktati i Berlinit", 1878-1887" në Universitetin e Eëconisit, I, f.143-45.*

23. *Miller, vepër e cituar, f.403; Hanotaux, Franca bashkëkohore, IV, f.573.*

Bullgarisë kërkuan kompensime territoriale në llogari të Turqisë. Në Greqi tre anëtarë të kabinetit të Delyannis mbrojtën kapjen e territoreve të kufijve të propozuar në Kongresin e Berlinit; por politika e tyre nuk u adaptua<sup>24</sup>. Atëherë Franca këshilloi Greqinë që të pranonte gjithë çfarë dëshironin Fuqitë e Mëdha, duke premtuar në të njëjtën kohë se ajo do të kërkonte zgjidhje ndaj kërkesave greke në një rast të përshtatshëm në të ardhmen<sup>25</sup>. Në një rast tjetër, më vonë, në kohën e luftës fatkeqe greko-turke më 1897, Greqia bëri edhe një përpjekje për të siguruar marrjen e provincës së lakmuar. Trupat helenike u dërguan në Epir dhe Thesali, por aty u mundën. Disfata e tyre u përdor prej Italisë për t'i treguar popullsisë së Epirit pavlefshmërinë e kalimit nga dominimi turk në atë grek<sup>26</sup>.

Periudha kohore pre Kongresit të Berlinit deri tek Lufta Ballkanike dëshmoi dy faza të reja të historisë së Epirit dhe të Shqipërisë; e para rritjen e nacionalizmit shqiptar dhe e dyta, rivalitetin kompleks në rritje të fuqive në këtë rajon. Këto dy

24. Miller, *vepër e cituar*, f.416.

25. Sergeant, *vepër e cituar*, f.316. Për të gjithë subjektin e rishikimit të Traktatit të Berlinit, *Historia e Europës Moderne, 1878, 1919, kapitulli I dhe IV*.

26. Miller, *vepëra e cituar*, f.436-37; Casanges, *Revista Dyjavore, CI, 474, (Mars, 1914)*.

lëvizje, të ndërthurura në mënyrë tejet të koklavitur, formojnë plotësisht shtrembërimin dhe ndërthurjen e historisë shqiptare gjatë periudhës në fjalë dhe janë të një rëndësie të dorës së parë për të kuptuar zhvillimet e saj të mëvonshme.

Shkalla e parë në rritjen e nacionalizimit shqiptar mund të gjurmohet me formimin e "Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" në vitin 1878 për mbrojtjen e të drejtave të Kombit Shqiptar". Kjo lidhje që u formua për të kundërshtuar çdo lloj kalimi të tokave të banuara prej shqiptarëve tek shtetet e saj fqinje, kundërshtoi shpërblimin që iu bë Malit të Zi pre kongresit të Berlinit duke i dhënë një copë të vogël të territorit shqiptar. Porta, duke shpresuar në moszbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, në fillim e favorizoi Lidhjen, por, kur sulltani konstatoi se ajo nuk ishte një vegël e përshtatshme për t'u përdorur, pasi përbënte bërthamën e një lëvizjeje të re kombëtare, e shpërndau atë me forcë<sup>27</sup>.

Atëherë shqiptarët me qëndrim jashtë vendit, si në Itali, Rumani dhe Belgjikë, aq sa edhe në Athinë, formuan komitetet e tyre për të propaganduar idetë kombëtare. Këto organizata ia arritën të shpërndajnë fshehtas brenda vendit libra, pamflete dhe gazeta të

27. Schevill, *vepër e cituar*, f.464-65; Chekrezi, *vepër e cituar*, f.51-52.

ndaluar prej autoriteteve otomane, për shkak se ato ishin shtypur në gjuhën kombëtare. Deri në vitin 1908 efekti i këtyre lëvizjeve në vetë Shqipërinë ishte i papërfillshëm, kryesisht në sajë të mungesës së edukimit masiv, i cili do të përbënte bazën e rritjes së ndjenjave patriotike tek masat e gjera, kështu që ndalimi i shkollave kombëtare shqipe nga turqit ishte i efektshëm<sup>28</sup>. Në vitin 1904, u mbajt në Bukuresht e para asamble kombëtare shqiptare. Ajo adoptoi një listë rezolutash që u tregonin turqve se atje ishin fillimet e një lëvizje të cilën ata tashmë duhej ta llogarisnin. Vëmendja e Europës u tërhoq nga kjo lëvizje e re me anë të një memorandum, të paraqitur prej shqiptarëve në Konferencën e Hagës të viti 1907, por pa rezultat<sup>29</sup>.

Paralel me këtë rritje të nacionalizmit shqiptar pat dhe një tjetër zhvillim, të një rëndësie të madhe për Shqipërinë, i cili e solli këtë vënd në arenën e politikës ndërkombëtare europiane. Si rezultat i pushtimit të Bosnjës dhe Hercegovinës prej Austro-Hungarisë, pushtim ky i njohur prej Traktati të Berlinit, Italia u bë xhelozë nga frika se mos ekspansioni austriak në

28. Vilari, *Çështja e Ballkanit*, f. 161; Bourchier, "Shqipëria" *Enciklopedia Britanike*, edicioni i njëmbëdhjetë.

29. Larmerous, *Politika e jashtme Austro-Hungarisë, 1875-1914*, II, 392-401.

Ballkan mund të merrte aq shumë bregdet, sa të arrinte tek hyrja e Detit Adriatik, dhe kështu merrte fund dëshira e saj për ta kthyer Adriatikut në një liqen italian. Këto vite njohën formimin e Aleancës Trepalëshe, e cila u krijua për kundër ose, ndoshta pjesërisht për shkak të urrejtjes dhe rivalitetit austro-italian. Një pike tjetër e ndjeshme në këtë aleancë ishte pengimi që i duhej bërë çdo lloj fuqie tjetër për të futur këmbët në Shqipëri. Ruajtja e status quo në Adriatik ishte kështu një kusht themelor. Që prej viti 1902 ishte rënë dakort midis tyre se në qoftë se këto lloj rregullimesh të bëra do të provonin se ishin jo praktike, të dyja do të punonin për zhvillimet autonome të shteteve ballkanike. Që prej asaj kohe, çështja shqiptare ishte gjithnjë e më shumë një objekt i përcjellur me interes nga opinioni publik italian dhe, me dështimin e planit të saj kolonial, pas pushtimit të Tunizit nga Franca në vitin 1880, thirrjet për shtrirje të sferës së influencës italiane në bregdetin tjetër të Adriatikut u bënë më të forta, ç'ka solli që çdo hap i ndërmarrë prej Austro-Hungarisë të shihej me mosbesim prej politikanëve dhe gazetarëve italianë<sup>30</sup>.

Përkundër një intervali të shkurtër, të kushtëzuar

30. Pribram, *Traktati sekret i Austro-Hungarisë, II*, f.114-15

prej Aleancës trepalëshe, dy fuqitë nuk ndenjën duarkryq ndaj dekadës që çoi në luftërat ballkanike. Veçanërisht rivalet u angazhuan në një “penetrimin paqësor” në Shqipëri. Austro-Hungaria kishte kohë që e kishte shtrirë influencën e saj atje, duke u bërë mbrojtëse e shqiptarëve katolike, falë privilegjeve të dhëna asaj që dy shekuj më parë<sup>31</sup>. Kështu, agjentët e saj bënë një propagandë të fuqishme katolike, duke shfrytëzuar priftërinë e fshatrave për të shpërndarë ndjenjat e këqia midis myslimanëve dhe kristianëve dhe nëpërmjet të kësaj ndërhyrjeje garantonte një pengesë serioze ndaj formimit të një nacionalizmi të fortë shqiptar<sup>32</sup>. Përveç kësaj influence fetare, Monarkia dualiste ushtroi kontroll në Shqipëri nëpërmjet subvencioneve sekrete për bejlerët më në zë të vendit<sup>33</sup> dhe nëpërmjet edukimit të studentëve në Austro Hungari për t’i kthyer pastaj në agjente të intrigave të saj.

Monarkia Dualiste duket besonte se duke inkurajuar çrregullimin publik, do të krijonte rrethana të tilla që t’i kërkohej që t’a pushtonte

31. Dillon, *Revista bashkëkohore* (1913) CIII, 732; për një listë të traktateve, etj. Polyvios, *Shqipëria në Konferencën e Asambleve në Londër*, f.27, shënime.

32. Woods, *Zona e rrezikshme e Europës*, f.92.

33. Schëertfeger, *Politika Europiane*, III, 256.

vendin, me qëllim për ta qetësuar atë, siç kishte ndodhur me rastin e Bosnje -Hercegovinës<sup>34</sup>. Në sytë e saj Shqipëria përbente vetëm njërën prej hapave që duheshin ndërmarrë në rrugën e saj për në Selanik<sup>35</sup>. Në krahasim me penetrimin austriak, ai italian ishte më pak sistematik e më pak efektiv. Monarkia Dualiste zotëronte gjasa më të mëdha se sa Italia, siç bënte të njohur Ministri i Jashtëm italian San Giuliano, pasi kishte avantazh afërsinë territoriale, paratë e përdorura me bollëk, tregti më të mirë me të, marinë më mirë të organizuar dhe marrdhënie më të përzemërta me Vatikanin dhe klerin<sup>36</sup>. Metoda italiene e penetrimit ishte ushtruar nëpërmjet lidhjeve të personelit, drejtorëve të policisë nga njëra anë dhe banorëve me influencë të Shqipërisë nga ana tjetër, ose nëpërmjet emigrimit të shqiptarëve për në Itali pas trazitave të ndodhura në Maqedoni<sup>37</sup>. Kështu me hapjen e siparit të shekullit të njëzetë, San Guliano këshilloi rritjen e influencës italiane në Shqipëri nëpërmjet marinës tregtare, shërbimit postar, agjentëve tregtarë e

34. Braisford, *Maqedonia, Rracat dhe e ardhmja e saj*, f.254-55.

35. Larmeroux, *vepër e cituar*, II, f.384.

36. Sosnosky, *Politika Austro-Hungareze në Ballkan (gjermanisht)* 1866, II, 253.

37. Larmeroux, *vepër e cituar*, II, f.388.

konsullore, shkollave, bankave, pra nëpërmjet një programi të tillë të pasur, i cili dukej i vështirë për t'u thënë e jo më për t'u realizuar. Ndoshta penetrimi më i suksesshëm mori formë nëpërmjet arsimimit. Numri i nxënësve, që ndiqnin shkollat italiane në Vlorë, Janinë dhe Shkodër, ishte rreth tre herë më shumë se sa numri i atyre që ndiqnin shkollat austriake në të njëjtat lokalitete<sup>38</sup>, ndërkohë që Italia, kishte gjithashtu drejtimin në Shqipëri<sup>39</sup>. Ndërsa influenca austriake ishte më e fuqishme në Veriun e Shqipërisë ajo e Italisë dukej se ndjehej më shumë veçanërisht në Jug, gjë që dukej se diktohej nga pozitat gjeografike respektive të të dy vendeve<sup>40</sup>. Që nga kjo kohë, ishte Italia ajo që iu kundërvu influencës greke.

Pretendimet e Greqisë ndaj Shqipërisë Jugore, të cilat, duhet thënë se ishin më të forta se sa ato Austro-Hungareze dhe italiane, përbënin arsyen kryesore për të ushqyer zemërimin më të thellë tek nacionalistët shqiptarë. Ajo e ushtronte influencën e saj në Epir nëpërmjet të tri agjencive të saj: patriarkanes, shkollave greke dhe vetë mbretërisë

38. *New York Times*, 1 Shkurt 1914.

39. *Braisfold*, *vepër e cituar*, 283, shënime.

40. *Cf. figurat e lundrimit të dhëna nga Larmeroux*, *vepër e cituar*, II, 395, shënime.

helenike. Qëllimet e propagandës gjatë kohës që po shqyrtojmë ishin, së pari, të krijonin pakënaqësira tek shqiptarët ndaj Turqisë, dhe më pas ata të helenizoheshin. Në përpjekjet e tyre në këto drejtime, grekët ndihmoheshin prej turqve, të cilët u lanë dorë të lirë në Shqipërinë Jugore duke penguar kështu një kryengritje të bashkuar të shqiptarëve dhe duke e kundërvënë një pjesë të vendit ndaj pjesës tjetër. Kisha Ortodokse i ndiqte me vëmendje ngjarjet në këtë rajon, dhe shkollat e saj, në të cilat gjuha greke ishte gjuha e folur dhe e mësuar, praktikisht afronin të vetmen mundësi për tu arsimuar. Parë nga ky këndvështrim është e qartë se influenca helenike duhej të ishte e fuqishme. Shtirja e kësaj influence, e cila formon bazën e kërkesave greke ndaj krahinës dhe që përbën themelin e të gjithë problemit, do të shfaqet më vonë.

Nën Sulltan Abdul Hamitin (1876-1909), shqiptarëve, megjithëse individualisht u ishte besuar të ishin anëtarë të qeverisë, nuk ishte bërë asnjë lëshim sa i takon nacionalizmit të tyre. Prej revolucionit të Xhon-turqve të 1908-ës, Shqipëria në fillim shpresoi për autonomi më të gjërë dhe gati sa nuk iu bashkua besnikërisht këtij

revolucionit<sup>41</sup>, por shumë shpejt çdo gjë u bë e qartë për nacionalistët shqiptarë. Shqiptarët e konceptonin perandorinë si një lloj federate të popujve autonome, ndërsa Komiteti “Bashkim e Përparim” kërkonte një qeveri tejet të centralizuar. Në përpjekjet e tyre për të përmbajtur dominimin mbi shqiptarët si popull mysliman, xhon-turqit dërguan katër ekspedita kundër Shqipërisë në më pak se dy vjet. Padyshim që politika agresive e Xhon turqve i përshpejtoi zhvillimet brenda nacionalizmit shqiptar duke e shtuar kundërshtimin në përmasa të papara ndonjëherë deri në atë kohë<sup>42</sup>. Politika e mëparshme e shqiptarëve, për të zhvilluar autonominë e tyre brenda Perandorisë Osmane, si një gur kalimi për të arritur më pas tek pavarësia, tashmë nuk kishte vlerë dhe u gjet si variant i pamundshëm, sa nga kundërshtimi i politikës së xhon turqve aq edhe nga rezultatet e luftës ballkanike.<sup>42</sup>

41. Shih vlerësimin e deputetit të nderuar shqiptar Ismail Qemal Bey në *The Quarterly Review*, CCXXVIII, 150-52; Gjithashtu Delaji, *Aspiratat autonome në Europë f.119, Peace Handbook, nr:17, f.93-95* Chekrezi, *vepër e cituar*, f.63

42. Ismail Kemal Bey, *citim*

### *III Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe Përcaktimi i Kufijve 1912-1914*

Çështja shqiptare ishte shkaku kryesor që çoi në luftën e Parë Ballkanike pasi ajo veproi si pale direkt përgjegjëse për shpërthimin e konflagracionit. Kur më 1912, Shqipëria u nda përfundimisht nga Turqia nëpërmjet një traktati, sipas të cilit, katër vilajetet, ai i Shkodrës, Janinës, Manastirit dhe Kosovës do të përfshihen brenda saj, shtetet fqinje vendosën të kundërshtonin krijimin e një Shqipërie si e tërë, sepse ajo do të shkelte rëndë mbi shpresat e tyre<sup>1</sup>. Por shqiptarët nuk morën pjesë aktive në Luftën e Parë Ballkanike, pasi ata tradicionalisht kanë shprehur antipati ndaj turqve; kësaj i shtohet tashmë edhe frika se mos një fitore e turqve do të çonte në një përtëritje më të madhe të përpjekjeve osmanizuese ndaj tyre, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, prej frikës që kishin nga grekët dhe serbët, të cilët donin ta ndanin këtë vend midis tyre, në se do t'ja arrinin dot. Në mes të Scyllas dhe Charybdis shqiptarët ushqyen të njëjtën urrejtje, si ndaj aleateve ballkanike ashtu edhe kundër Turqisë.

1. Schervill, *Historia e Gadishullit Ballkanik*, f.466.

Kështu, si një protestë kundër përpjekjeve serbe për të siguruar dalje në det në kurriz të Shqipërisë dhe me shpresë se kështu do të siguronin veten pa u kthyer në një plaçkë lufte, në vjeshtën e vonë të 1912-tës, shqiptarët e shpallën pavarësinë e tyre. Kjo ngjarje kuptmplotë ndodhi në Vlorë, më 28 nëntor 1912<sup>2</sup>. Kryetari i Qeverisë së Përkohëshme Shqiptare të themeluar, u bë Ismail Qemal Bey siç e njoftonte më telegraf Kontin Bertold, Ministri Austriak i Punëve të jashtme:

Asambleja Kombëtare e përbërë prej delegatësh nga të gjitha anët e Shqipërisë pa dallim feje, e mbledhur sot në qytetin e Vlorës, ka shpallur pikërisht theelimin e Qeverisë së Përkohëshme, e ngarkuar të mbrojë ekzistencën e popullit Shqiptar, i rrezikuar sa prej shfarosjes nga ana e ushtrive serbe, aq edhe me dorëzim të tokave kombëtare ushtrive Aleate<sup>3</sup>.

Përpara se të mbahej mbledhja, Ismail Qemal Beu e kishte diskutuar çështjen shqiptare me Bertoldin në Budapest. Burri i shtetit Austriak i kishte aprovuar pikpamjet e tij rreth çështjes Shqiptare dhe i kishte

2. Austria, Dokumente Diplomatike për Ballkanin, 1912-'13 Nr. 134, Lejhanec për për Berchtoldin.

3. Austria, Dokumente Diplomatike rreth Ballkanit, 1912-'13, Nr. 136. 28 nëntor 1912.

vënë atij një anije në dispozicion. Zgjedhja e tij si kryetar ishte paraprirë prej ngritjes dramatike të një flamuri të moçëm shqiptar të heroit shqiptar Skënderbeg dhe ishte shoqëruar me njoftimin e Fuqive dhe Portës për themelimin e shtetit të ri, bashkë me një kërkesë për njohjen e tij<sup>4</sup>.

Përpara se të shikonin në se kjo lëvizje e shqiptarëve, e përkrahur nga Austrija, ishte apo jo e qëlluar, hapat e marra prej fuqive Evropiane për të përfunduar luftën, rezultuan në firmosjen e një armëpushimi më 3 Dhjetor midis Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi nga njëra anë dhe të Turqisë nga ana tjetër. Arsyeja kryesore pse Greqia kundërshtoi të firmoste armëpushimin ishte se ajo kërkonte që të kalonte drejt Epirit e veçanërisht drejt fortesës së Janinës. Ky fakt ishte shfaqur qartë në deklaratën e Ministrit grek, Romanos, në subjektin e refuzimit të tij; kushtet e aleatëve të cilat ishin të pranueshme për Greqinë, por jo për Turqinë, përfshin dorëzimin e Janinës<sup>5</sup>. Për Shqipërinë, rëndësia e rezistencës së

4. Vlerësimi i Ismail Qemal Beut në Dako, Shqipëria çelësi për në Lindjen e Afërt. f.117, -19. Flamuri i Skënderbeut, tani flamuri i Shqipërisë.

Si një shifter në qiell që fluturon

Flamuri i Skënderbeut valon

Shqiponja dykrenare kombin krenaron

"Nga Historia e Skënderbeut"

5. Le Temps, 3 Dhjetor 1912.

zgjatur të Janinës, nuk mund të mos vlerësohet. Thuhet se rezistenca e Janinës dhe Shkodrës bënte të mundur që Europa të themelonte një Shqipëri autonome<sup>6</sup>. Edhe pse në një luftë të pandërprerë, Greqia megjithatë mori pjesë në Konferencën e Ambasadorëve.

Londrës, në Dhjetor, e thirrur për të gjetur zgjidhje efektive ndaj luftës në Ballkan.

Nënshkrimi i armëpushimit ishte shoqëruar shpejt me një njoftim mbi karakterin zyrtar që kishte propozimi i Eduard Greyt për një konferencë ambasadorësh, gjë të cilën Franca e kishte pranuar<sup>7</sup>. Mbledhja e parë e Konferencës u mbajt më 18 Dhjetor,<sup>8</sup> nën drejtimin e Sër Eduard Greyt. Por përpara hapjes së konferencës, bisedimet midis fuqive të ndryshme kishin rezultuar në qëndrime të parapërcaktuara në çështjen më të rëndësishme që do të vendoseshin, përkatësisht mbi çështjen shqiptare.

Austro-Hungaria dhe Italia në veçanti, si dy vendet më të interesuara rreth problemit shqiptar, nuk kishin ndenjur duarkryq. Që me 5 nëntor Ambasadori Austro-Hungarez në Londër i kishte telegrafuar

6. Young, *Nacionalizmi dhe lufta në Lindjen e Afërt*, f.201.

7. *Le Temps*, 6 Dhjetor, 1912.

8. *Po aty*, 20 Dhjetor, 1912.


Beogradit: “Në bisedimet e sotme Sër Eduard Grey tha që Shqipëria duhej të ishte autonome, gjë për të cilën është arritur marrëveshje e plotë. Tani mbetej vetëm zgjerimi i kësaj autonomie territoriale<sup>9</sup>”. Italia ishte gjithashtu aktive. Ministri Italian në Çetinjë e informoi mbretin e malit të Zi se integriteti dhe autonomia e Shqipërisë formonte bazën e politikës italiane<sup>10</sup>. Ky njoftim, ndonëse i përcjellë tek fqinji verior, në të vërtetë tregonte një princip të përgjithshëm të politikës italianë. Austro-hungaria dhe Italia në fakt përshkuheshin qartë prej Bertoldit si “...palë që janë duke punuar për Autonominë e Shqipërisë<sup>11</sup>”.

Në bisedimet e bëra përpara se të hapej Konferenca, ashtu siç del nga korespondenca e Bertoldit me ministrat e Austro Hungarisë, kufijtë jugorë, ose më qartë çështja vitale e Vlorës, zuri një vënd të dukshëm. Kërkesat e Greqisë ndaj këtij rajoni, me një rëndësi të posaçme, gjetën një mbrojtje të zjarrtë prej, Venizellos. Ky i fundit u pajtua me propozimin e Ministrat Italian të Punëve të Jashtme, San Guiliano që Italia dhe Austro-Hungaria, duhej

9. *Austro-Hungaria- Dokumente Diplomatike rreth çështjeve Ballkanike*. 10. -1912-'13, Nr.75, Mensdorff për Berchtold.

10. *Po aty*, nr.98. fon Giesel për Berchtold, 13 Nëntor 1912.

11. *Po aty*, nr 147. Berchtold për fon Braun, 3 Dhjetor 1912.



Harta 1

Harta 2

Harta 3

Harta 1 - Propozimet Austro-Hungareze dhe Ruse, Dhjetor 1912. Harta 2. - Kërkesat Austro-Hungareze dhe Italiane, kërkesat e Venizellosit dhe linja e vendosur prej Konferencës së Ambasadorëve, Gusht 1913. Harta 3. - Kufijtë e propozuar prej Aleatëve Ballkanikë, Janar 1913. (Marrë nga Ministria e Punëve të Jashtme Austro-Hungareze)

t'i deklaronin zyrtarisht qeverisë Greke pamundësinë e tyre për të lejuar aneksimin e Vlorës dhe ishullit të Sazanit prej kësaj të fundit<sup>12</sup>. Por në të njëjtën kohë ai kërkonte tërë gadishullin e Kepit Glossa dhe një port në gjirin e Vlorës për Greqinë. Megjithatë ai e njihte të drejtën e ekzistencës për një shtet shqiptar, të mbështetur në principlot e nacionalitetit që jepte siguri se kufijtë e tij nuk do të shkelnin mbi sferën greke të interesave dhe kufijtë greke ku flitej kjo gjuhë. Këta kufij, siç pihonte ai, fillonin diçka në vri të Vlorës.<sup>13</sup> Në kërkesat e tyre lidhur me Vlorën dhe Sazanin, Roma dhe Vjena patën dhe mbështetjen e Berlinit<sup>14</sup>. Ndaj kërkesave të Venizellosit për marrjen e një pjese të gjirit dhe të një porti, Qeveria italiane ra dakort me 10 Dhjetor, me kusht që Vlora t'i mbetej Shqipërisë. Në të njëjtën ditë Bertoldi informoi ministrin Austro-Hungarez në Romë se ai kishte marrë vesh nëpërmjet ambasadorit italian në Vjenë, Dukës së Avarnës, se Consulta i ishte rikthyer propozimit të Poinkares në lidhje me kufijtë jugorë të Shqipërisë së re. Sipas këtij propozimi vija do të kalonte në

12. Austro-Hungaria, Dokumente Diplomatike rreth çështjeve ballkanike. 1912-'13, nr.75. Mensdorff per Berchtold.

13. Po aty, nr.154, Berchtold për fun Meroy, 8 Dhjetor 1912.

14. Po aty, nr.155, Szogyeny për Berchtold, 9 Dhjetor 1912.

bregdetin e Butrintit. San Guliano, duke analizuar dëshirën greke për të përfituar rajonin bregdetar të Himarës si kërkesë të tejskajshme, por duke vlerësuar se Janina i duhej dhënë asaj për shkak të aspiratave ortodokse greke, favorizonte taktikat e kalimit të kufirit në Lumin Kallamas dhe kështu lejonte që Janina t'i dilte duarsh Shqipërisë. "Kjo do të përbente një bazë për diskutim duke i lëshuar pe Greqisë, por Vlora kurrsesi nuk do t'i lihej Mbretërisë Greke."<sup>15</sup>

Ministri Austro-Hungarez në Athinë, von Braun, raportonte më 14 Dhjetor se ideja për pavarësinë e Shqipërisë nuk është pritur mirë në Athinë, megjithëse dukej se ishte hequr dorë nga ideja e copëtimit të saj.

Për më tepër burrat e shtetit grek vazhdimisht deklarorin se ata nuk dëshironin ndonjë pjesë të Shqipërisë, por nuk ishte e qartë se çfarë kuptonin ata kur i referoheshin Epirit Grek. Von Braun e lejoi elasticitetin e kufijve të vërtetë midis Shqipërisë dhe Greqisë. Venizellosi e përshkoi vijën kufitare nga burimi i lumit Vjosa pak më në veri të Përmetit duke e shtrirë atë më në veri të Korçës, Por në këtë pikë Von Braun shënoi se Venizellosi kishte lëshuar

15. Po aty, nr.161, Berchtold për fon Merex, 10 Dhjetor 1912.

tanimë pe sa i takon asaj që kishte të bënte me kursin e ultësirës së Vjosës, po të kemi parasysh heqjen dore prej kërkesave ndaj Vlorës<sup>16</sup>.

Ndërsa, përpara se të hapej konferenca, qëndrimi i Austro-Hungarisë dhe Italisë favorizonte një Shqipëri të madhe dhe autonome, kurse Greqia punonte për shtrirjen e kufijve të saj drejt veriut, qëndrimi i Francës ishte thujse i papërcaktuar. Në kundërshtim me aleancën treopalëshe, Poincare dëshironte t'i shikonte kufijtë e Shqipërisë sa të ishte e mundur më të cinguar<sup>17</sup>.

Që në hapjen e Konferencës së Ambasadorëve u ra praktikisht dakort për autonominë dhe asnjësinë e Shqipërisë. Në konferencë, instruksioni i dhënë i Mensdorffit, Ambasador i Austro-Hungarisë në Londër, e vinte theksin para së gjithash në një organizëm për Shqipërinë i cili do t'i lejonte asaj zhvillimin autonom. E një rëndësie të dorës së dytë ishte çështja në se a do të kishte pavarësi të plotë apo do të ruhej ndonjë farë kontrolli mbi të nga ana e sulltanit. Në të dyja rastet autonomia dhe neutraliteti i Shqipërisë do të duhej të deklarohet prej të gjitha Fuqive të Mëdha po aq sa edhe prej

16. Po aty, nr.164, Fon Broun për Berchtold, 14 Dhjetor 1912.

17. Schreiner, Diplomacia e Antantes në Botë, f.434.

Shteteve Ballkanike<sup>18</sup>. Ajo çfarë theksonte Franca ishte diçka e ndryshme. Poincare e këshilloi ambasadorin francez në Londër, Mr. Paul Cambon, që ai të mos pranonte një autonomi të plotë për Shqipërinë dhe ndjente keqardhje kur përmendej ky term dhe liheshin mënjanë referencat ndaj asnjësisë dhe kontrollit prej Fuqive.

Kontrolli evropjan mbi këtë çështje ishte i një rëndësie parësore për Franën.<sup>19</sup>

Veprimtaritë e fillimit të punës së Konferencës në takimet e saj të para u përmblodhën në një deklaratë zyrtare të lëshuar me 21 Dhjetor nga ana e Foreign Ofisit Britanik:

“Ambasadorët u kanë rekomanduar Qeverive të tyre dhe më vonë i kanë pranuar principet e një Shqipërie autonome, me një klauzole që garanton ndaj Serbisë dalje për tregti në Adriatik. Të gjashtë qeveritë janë marrë vesh rreth principeve të atyre pikave”<sup>20</sup>.

Gjatë një ndërprerjeje të shkurtër që u bë, Poincare u muar me çështje në pikat e tyre të përgjithshme

18. *Austro-Hungaria, Po aty, nr.166, Berchtold për Mansdorff, 15 Dhjetor 1912.*

19. *Francë, Dokumente diplomatike mbi çështjen ballkanike, 1912-'14, nr.24. Poincare për Paul Cambonin.*

20. *The Times, (Londër), 21 Dhjetor 1912.*

gjatë një fjalimi të mbajtur në Senatin Francez më 21 Dhjetor. Me atë rast ai veç të tjerash tha:

“Eshtë padyshim zgjidhja më e natyrshme dhe e paanshme zotërinj, që Ballkani që tani e tutje tu takojë popujve të Ballkanit, grekëve, serbëve, malazezëve, shqiptarëve. Kjo sjell atë që seicili të paraqesë garancitë më të mira të qëndrueshmërisë dhe stabilitetit.

Në bisedimet që po mbahen në Londër për këtë problem... unë shpresoj se kjo pikë do të adoptohet pa vështirësi prej të gjitha Fuqive. Që tani principet e një Shqipërie autonome nën kontrollin e të gjitha Fuqive të Mëdha duke përfshirë këtu edhe francën është pranuar... Mbetet përcaktimi i regjimit dhe kufijve të Shqipërisë. Në këtë përcaktim ne nuk do të harrojmë të marrim parasyshë interesat e grekëve, bullgarëve, serbëve dhe malazezëve”<sup>21</sup>.

Përpara se Konferenca të fillonte mbledhjen e saj në Londër më 2 Janar 1913, shtetet ballkanike të interesuara rreth çështjes shqiptare dhe banorët e territoreve përkatëse u ngritën në veprim. Shqiptarët vetë ishin të etur për të njohur vlefshmërinë e përpjekjeve të Austro-Hungarisë dhe Italisë për

21. *Francë, Documenta diplomatike mbi çështjen Ballkanike, 1912-'14, II, nr.472.*

autonominë e Shqipërisë. Ismail Qemali i paraqiti vetë falenderimet konsujve të dy vendeve në Vlorë ndërsa Sër Eduard Greyt dhe Ministrave të tjerë të Punëve të Jashtme të Fuqive të Mëdha ua paraqiti ato me shkrim.<sup>22</sup>

Në mbledhjen tjetër të Konferencës shqiptarët paraqitën një momerendum tek Sër Eduard Grey. Kërkesat e paraqitura arsyetoheshin si më poshtë “.. përse Shqipëria e ngrinte zërin e saj për të kërkuar nga Fuqitë Europiane të drejtën për të jetuar dhe mundësinë e zhvillimit normal e paqësor”, sepse ata formonin një grup etnik kompakt e homogjen; që prapambetja e tyre kishte ardhur për shkak të konditave jo favorizuese që e rrethonin dhe që nënshtrimi i tyre kishte qënë vetëm në dukje pasi ata kishin qënë vazhdimisht të angazhuar në luftë për mbrojtjen e lirisë së tyre. Duke u drejtuar me thirrjen “Ballkani për popujt e ballkanit” memorandum i vazhdonte: “Të vendosësh nën dominimin e huaj, territore ku popullata shqiptare është me shumicë dotë thotë të mbjellësh farën e përjetshme të çrregullimeve dhe trazirave. “Kufijtë e përcaktuar specifikisht nuk bën të përfshihen në

22. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-13, nr.190. Lejhanec për Berchtold, 22 Dhjetor 1912.*

Epirin e Veriut. Për të siguruar marrdhënie të përzemërta me fqinjët e tyre, shqiptarët sygjjuan një komision të përzier për përcaktimin e kufijve, me arsyetimin se një trup i tillë, duke qënë i pa paragjykuar, nuk do të nxiste kundërshtime midis vendeve fqinje.<sup>23</sup>

Qeveria greke gjithashtu i paraqiti kërkesat e veta në një meremendum për kufijtë e Epirit. Greqia deklaroi me forcë se duke mos qënë e angazhuar në një luftë pushtuese, por çlirimtare, dëshironte një paqe të qëndrueshme, të cilën do ta siguronte shtrirja e kufijve gjatë vijave strategjike, ekonomike, dhe etnografike. Ajo shprehimisht hoqi dorë nga kërkesat e saj ndaj Vlorës por në të njëjtën deklaroi marrjen e Janinës si absolutisht të domosdoshme. Nëpërmjet Janinës duhej të shkohej natyrshëm drejt portit të Sarandës përderisa një linjë e mbetur në bregdetin përballë Korfuzit në dorë të një fuqie tjetër, do të krijonte një rrezik të përhershëm për Greqinë. Marrja e krahinës së rëndësishme të Gjirokastrës, të cilën gjithashtu e kërkonte Greqia, arsyetohej me faktin se ky rajon, si rezultat i faktorëve gjeografike, është i lidhur me Sarandën dhe në qoftë se do të ndahej

23. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike rreth çështjeve Ballkanike, 1912-13, nr.190. Lejhanec për Brchtold 22, Dhjetor 1912.*

prej atij porti, do ta mbulonte amullia.

Për më tepër, vazhdonte dokumenti, Lugina e Korçës do të ishte gjithashtu e domosdoshme. Duke komunikuar me detin vetëm nëpërmjet Janinës dhe Sarandës, ajo formonte bashkë me Janinën e Gjirokastrën një njësi të pandashme. Përkrah argumenteve strategjike dhe ekonomike të përdorua, memorandumimi përligjite aneksimin e këtij territori nga Greqia edhe mbi baza etnografike, duke shpallur se dy të tretat e banorëve ishin grekë, bile edhe po tu referohej statistikave turke.<sup>24</sup>

Në drejtim të Konferencës së Ambasadorëve kishin vërshuar memorandume të panumërta të së njëjtës natyrë dhe qëllim nga banorë të qyteteve të ndryshme dhe krahinave të "Epirit të Veriut". Rërkeja e kërkesave për bashkim me Greqinë u derdh prej janarit deri në prill nga epirotët në Egjipt dhe Sudan, prej Korçës, Delvinës, Himarës, Kolonjës, Përmeitit dhe Leskovikut. Si model i tonit të këtyre kërkesave mund të merret ajo që paraqiti populli i Korçës në shkurt. Në të i kërkohej Konferencës të caktonte një komision special "për të shqyrtuar aspiratat dhe ndjenjat e popullsisë së krahinës sonë",

24. "Kujtime rreth vendosjes së kufijve të Epirit". Tekst i marrë nga Valley, *Irredentizmi helenik* f.199-211.

duke treguar në të njëjtën kohë se ndonjë vendim i marrë në kundërshtim me aspiratat e tyre për bashkimin me Greqinë do të shpinte në katastrofë<sup>25</sup>. Këto përpjekje për t'i bërë pikpamjet e njohura nëpërmjet kërkesave nuk qebnë aq të suksesshme, pasi Konferenca i kushtoi pak vëmendje atyre.

Ndërkohë, gjatë dy muajve të parë të vitit të ri, vëmendja e Fuqive u përqëndrua tek kufijtë veriorë të Shqipërisë. Por gjatë kësaj periudhe dy pikëpamje të rëndësishme u zhvilluan më tej. Që më 3 janar 1913, Bertoldi insistoi që kufijtë tanimë ishin përcaktuar prej konferencës në pikat e saj esenciale, dhe që një komision kufijsh, nëqoftëse formohej, duhej të punonte në vënd vetëm për zbatimin e vendimeve të arritura që më parë<sup>26</sup>. Edhe më kuptimplotë ishte uniteti i vendosur prej Ausro-Hungarisë dhe Italisë për të kundërshtuar kërkesat greke.

Bertoldi e raportoi bisedën e tij me Dukën e Avarnës me këto fjalë:

"As kabineti i Vjenës e as i Romës nuk e dhanë pëlqimin e tyre ndaj përcaktimit që ekziston në pikpamjen e Qeverisë greke dhe që ka për tendencë

25. Valley, *vepër e cituar*, f.220, Teksti i rezolutave të tjera f.211-257.

26. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike mbi çështjet Ballkanike, 1912-'13, nr.207, Berchtold për Mensdorff.*

të ndajë nga Shqipëria territore të cilat të dy qeveritë i konsiderojne esencialisht të domosdoshme për vitalitetin e shtetit shqiptar<sup>27</sup>.

Më 6 mars çështja shqetësuese e kufijve veriore të Shqipërisë u la mënjanë prej Konferencës, e cila vendosi të procedonte me diskutime rreth përcaktimit të kufijve jugore dhe juglindorë.<sup>28</sup> Vendimi u arrit bash në momentin kur fortesa e Janinës ra në duart e grekëve.

Kapja e Janinës prej grekëve dhe rënia e Adrianapolit më 26 mars, bënë të mundur krijimin e një baze paraprake të paqes midis aleatëve ballkanikë dhe Turqisë në fund të marsit. Kështu u sigurua që Turqia do t'u lëshonte shteteve aleate të gjitha territoret që gjendeshin në perëndim të vijës Enos-Midia me përjashtim të Shqipërisë, përcaktimi i kufijve dhe regjimi i së cilës do t'i lihej në dorë Fuqive.<sup>29</sup>

Duke i pranuar këto kushte të fuqive, aleatët lanë për të shqyrtuar më vonë efektin që ata duhet të njihnin si një parakusht të domosdoshëm kufijtë e

27. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike mbi çështjen ballkanike, 1912-'13, nr.217, Berchtold për fon Braun, , 6 Janar 1913.*

28. *Po aty, nr.313, Mensdorff për Berchtold, 6 mars, 1913.*

29. *Franca, Dokumente diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-'14, II. 194, 31 Mars 1913.*

parashikuar të Shqipërisë, duke shpresuar që ata do të përshtateshin me ato që ishin propozuar në Londër.<sup>30</sup>

Atëherë, fuqitë u përgjigjën se "ato ishin gati për t'u bërë të njohur aleatëve përcaktimin e kufijve veriorë dhe verilindorë të Shqipërisë dhe përcaktimet në jug dhe juglindje do tu komunikoheshin atyre menjëherë sapo të vendoseshin"<sup>31</sup>.

Por ndërsa Shqipëria u formua, me Maqedoninë, e cila po shkëputej si rezultat i dëbimit të turqisë nga më të shumtat e dominimeve të saj në Europë, shtetet ballkanike ndjenë natyrshëm një interes të fortë e të veçantë për përcaktimin dhe ndarjen e pjesëve që po shkëputeshin. Prandaj, në pranimin e ndërmjettësimit të fuqive atat rezervuan "të drejtën që gjatë zhvillimit të bisedimeve të bisedojnë me Fuqitë e Mëdha çështjet që kishin të bënin... me fiksimin përfundimtar të kufijve"<sup>32</sup>.

Ndërsa bisedimet në Londër po vazhdonin, ende pa u marrë një vendim lidhur me kufijtë jugorë të Shqipërisë, u përhap një thashathemnaje sipas së cilës Austro -Hungaria dhe Italia po bënin plane për ta

30. *Poa ty, nr.214, Devile për Pichon për Bombard, 9 prill, 1913.*

31. *Po aty, nr.224, Pichon për Bombard, 9 Prill, 1913.*

32. *Po aty, nr.247, 21 prill 1913.*

pushtuar dhe për ta ndarë midis tyre<sup>33</sup>. Kjo e detyroi Francën që të merrte masa për të shmangur<sup>34</sup>. Franca shfaqti shqetësimin të thellë për faktin se çështja shqiptare po trajtohej si çështje, evropiane dhe jo si një çështje të Fuqive të Aleancës Trepalëshe. Kështu Ministri i Jashtëm Francez deklaroi: “Me kërkesën e Austrisë dhe Italisë, Fuqitë vendosën dhjetorin e kaluar që Shqipëria të kishte një shtet autonom nën garancinë dhe kontrollin e tyre. Asnjëri prej tyre nuk e ka denoncuar marrvëshjen e arritur; atëherë ato duhet të procedojnë besnikerisht për zbatimin e saj”. Por në rast se Austro-Hungaria dhe Italia do t’i zbarkonin trupat në bregdetin shqiptar ai shpalli se “Fuqitë e tjera duhet të marrin pjesë në veprime luftarake për të treguar karakterin Evropian dhe natyrën e përkohëshme të pushtimit”<sup>35</sup>.

Me këtë trajtim të çështjes u pajtua edhe Rusia, besnike ndaj aleateve të saj, duke shprehur besimin se detyra e Fuqive duhej të ishte e kufizuar ndaj Shqipërisë Veriore, përderisa pjesa jugore nuk ishte përcaktuar ende dhe vazhdonte të ishte e pushtuar prej trupave greke.<sup>36</sup> Në një përpjekje të dëshpëruar

33. Po aty, nr. 271, Jules Cambon për Pichon, 30 prill, 1913.

34. Po aty, nr.287, Pichon për Paul Cambon, 3 Maj, 1913.

35. Po aty, nr. 289, Pichon për Paul Cambon, 4 Maj, 1913.

36. Po aty, nr.292. Notë për ambasadën ruse, 4 Maj, 1913.

për të parandaluar konflagracionin që të mos përhapëj në drejtim të Evropës, siç kishte shumë të ngjarë të ndodhte, Ministri i Jashtëm Britanik, Sër Eduart Grey, nën kryesinë e të cilit u mbajt mbledhja e ambasadorëve në Londër, punoi i vendosur për një kompromis midis kërkesave të grekëve dhe italianëve në çështjet e kufirit jugor të Shqipërisë. Përpjekjet e Greyt u mbështetën prej Pichonit, por më vonë burri i shtetit deklaroi se shtypi zyrtar i Romës nuk e bëri detyrën e vet me kujdesin e duhur derisa Franca ishte paraqitur si kundërshtar i Italisë, një pikëpamje e cila, deklaronte ai, ishte dukshëm e ndryshme nga qëndrimi i tij.<sup>37</sup>

Fuqitë nuk kishin arritur ende të zgjidhnin çështjen shqiptare në një mënyrë të kënaqshme ndaj interesave të veta kur më 30 maj, traktiti i Londrës vendosi paqen midis Bullgarisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë, nga njëra anë dhe Turqisë, nga ana tjetër, Neni i tretë i traktatit deklaronte që Aleatet Ballkanike dhe Turqia duhet të kalonin në sovranitetin e Fuqive të Mëdha “detyrën e përcaktimit të kufijve të Shqipërisë dhe të gjitha çështjet e tjera që kishin të bënin me të”<sup>38</sup>. Pajja e

37. Francë, Dokumente Diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-14. II, nr.300, Pichon për Deville, 21 maj, 1913.

38. Tekst në Çështjet Lindore, Peace Handbook, nr.15.f.132-33.

vendosur me atë rast u provua se ishte e pasigurtë. Një muaj më vonë shpërtheu Lufta e Dytë Ballkanike e cila erdhi si rezultat i mosmarrveshjes midis aleatëve ballkanik në grindje për ndarjen e Maqedonisë, por zgjati vetëm deri në dorëzimin e Bullgarisë më 31 korrik, për tu pasuar me nënshkrimin e Paqes së Bukureshtit më 10 gusht.

Sidoqoftë kjo luftë nuk ndikoi drejtëpërsëdrejti në situatën në Shqipëri por Fuqitë në Londër vazhduan përpjekjet e tyre për të përfunduar zgjidhjen e çështjes në një mënyrë të kënaqëshme për veten e tyre. Traktati i Londrës nuk u nënshkrua derisa delegacioni grek i përbërë prej Skuloudis, Gennadius dhe Streit, dërgoi një deklaratë në Foreign Office Britanik. Ky dokument kërkonte që kur Fuqitë të diskutonin çështjet që çënonin interesat vitale të Greqisë, duhej të pranonin të dëgjonin përfaqësuesit e saj dhe që ata të merrnin në konsideratë dëshirat e popullsisë së çliruar.<sup>39</sup>

Përpara se të arrihej tek zgjidhja e tejshtyrë e çështjes së kufijve të Shqipërisë, Franca ndërmoi bisedime në një orvatje për të arritur disa lëshime të favorshme ndaj kërkesave greke nga Austro-

39. Francë, *Dokumente diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-'14*, II. No.308, Paul Cambon për Pichon, 31 maj 1913.

Hungaria dhe Italia. Kur M. Paul Cambon dhe Sër Eduart Grey e diskutuan këtë çështje, ky i fundit shfaqti mendimin se ata do të fillonin në kepin e Stillos në Adriatik dhe një komision ndërkombëtar do të vendoste kufijtë do të mund të gjenin njëkompromis sipas të cilit kufijtë do të fillonin në kepin e Stillos në Adriatik dhe një komision ndërkombëtar do të vendoste kufijtë në drejtim të Korçës. Këtë procedurë, Grey ia sugjeroi ministrit të Greqisë i cili u duk de e miratoi atë. Franca gjithashtu i kërkoi Greqisë t'ia lente Gjyrokastren Shqipërisë me shpresën që Greqia të shpërblehej duke mbajtur Korçën.<sup>40</sup>

Nëqoftëse Greqia do të përfitonte përveç Korçës, Ishujt e Egjeut dhe me shpresë Imbron dhe Tenedon, Kamboni shprehu mendimin se se Franca në atë rast do të ishte " e aftë ta bindte atë të pranonte një zgjidhje, të cilën ajo do të konsideronte si të favorëshme<sup>41</sup>. Në fakt që prej asaj kohe çështja e Shqipërisë Jugore u lidh ngushtë me atë të ishujve Egje, të cilët ishin konsideruar si kompesim i mundshëm që i afrohej Greqisë si kusht për mospranimin nga ana e Aleancës Trepalëshe të

40. Po aty, nr.316, Pichon për ambasadorët francezë 6 Qershor 1913.

41. Po aty.

kërkesave të saj ndaj pjesëve të Shqipërisë të kërkuara për shtetin e ri. Në përputhje me rekomandimin francez, dhe me qëllim që të provonte shpirtin e saj pajtues, Greqia lëshoi pe. Nëqoftëse do të kënaqeshin kërkesat e Greqisë duke i dhënë asaj ishujt të cilët i mbante Italia, ajo do të hiqte dorë nga bregdeti deri në Kepin e Stillos. Por ajo e bëri këtë sakrificë të madhe vetëm me të drejtën që në këmbim të kësaj të mbante luginën e Drinos, Përmetin dhe Korçën dhe të merrte të gjithë ishujt duke mos lënë asnjë prej tyre, ose, në se lente ndonjë, ata mund të ishin Imbro dhe Tenedo.<sup>42</sup> Duke mos përfillur faktin që kjo vije kufitare i ishte komunikuar Skouloudisit<sup>43</sup>, prej qeverisë Greke, Sër Eduart Grey i kërkoi ambasadorit francez dhe rus të konsultoheshin me qeveritë e tyre rreth një sugjerimi për vendosjen e një komisioni ndërkombëtar për të tërhequr një vijë kompromisi midis tyre propozimeve itaiane dhe greke vijë e cila fillon prej kepit të Stillos, Në qoftë se Fuqitë do të binin dakort me këtë propozim, kabineti i Athinës duhej të ftohej për tu marrë vesh që të opranonte kufijtë e

42. *Austro-Hungaria, Nota diplomatike për përfaqësitë në vendet ballkanike, 1912-14, II nr.335, Deville për Pichon.*

43. *Franca, Dokumente diplomatike mbi çështjet ballkanike, 1912-14, II. No.335, Deville për Pichon, 15 qershor 1913.*

përkushtuar në këtë mënyrë<sup>44</sup>. Franca ishte gati të pranonte me kusht që e ardhmja e ishujve do të përcaktohej në fillim. Pichon gjithashtu e përsëriti mendimin që Korça i duhej lënë Greqisë<sup>45</sup>. Por në këtë pikpamje Austro-Hungaria qëndroi e vendosur, falë politikë së saj për një Shqipëri të gjerë. Refuzimi nga ana e Monarkisë Dualiste ndaj propozimit të Francës çoi në një situatë delikate, në të vërtetë aq delikate, sa e detyroi Cambonin të bënte thirrje për durim të mëtejshëm, : "për të mos lejuar në asnjë mënyrë ndërprerjen e Konferencës së Londrës"<sup>46</sup>.

Franca si mbrojtëse e interesave greke dhe kundërshtarë e Aleancës Trepalëshe përdori tërë fuqinë e saj për të mbajtur Korçën për Greqinë. Delcasse, në atë kohë ambasador i Francës në Shën Petersburg, ishte veçanërisht në të mirë të kësaj pikpamje; por i pyetur prej Ser Eduart Greyt në se Austro-Hungaria paraqiste kundërshtime të pakapërcyeshme apo jo, Pichon e njoftoi Deliccase-

44. *Francë, Dokumente diplomatike, II, nr.337, Paul Cambon për Pichon, 16 janar 1913. Për tekstin e shpërndarë të kabinetit të Athinës tek Skoloudis, i cili komunikoi me parlamentin grek prej Venezillosit, 25 Nëntor 1913; Çështje greko-shqiptare f.123-24.*

45. *Poaty, nr 341, Pichon për Paul Cambon, 17 qershor 1913.*

46. *Po aty, nr.348, Pichon për Delasse, 28 Qershor 1913; Austro-Hungarias, Nota diplomatike për përfaqësitë në Ballkan, 1912-'13, nr:667, Szeccsen për Berchold, 5 Korik 1913.*

në se një zgjidhje e tillë nuk mund të konsiderohej zgjidhje. <sup>47</sup> Në pikëpamjen e kundërshtimit nga ana e monarkisë Dualiste, Pichoni i propozoi Tittonit me 3 Korrik se Austro Hungaria dhe Italia duhej që në mënyrë të kushtëzuar të pranonin propozimet e Sër Eduart Greyt për një komision për përcaktimin e kufijve, duke ja lënë me çdo kusht Gjirokastrën dhe Korçën Shqipërisë. Pichon u detyrua të nënshtronte dhe pranoi se ai nuk do të kundërshtonte një propozim të tillë, nëse ai do të vinte nëpërmjet Austro-Hungarisë dhe Italisë. <sup>48</sup>

Instruksionet që kishte marrë Comboni në dhjetë ditët e fundit për të mbështetur Greqinë në kundërshtimet e saj për të mos e lëshuar Korçën siguruan një veprim të tillë sa të mos shpërndahej Konferenca, edhe pse ajo shfaqte papajtueshmëri të thella <sup>49</sup>.

Në punimet e Konferencës së Ambasadorëve më 1 gusht, Sër Eduart Grey shprehu mendimin se mund të arrihej një marrëveshje në pikat më të rëndësishme siç ishte krijimi i një komisioni ndërkombëtar për përcaktimin e kufijve juglindorë

<sup>47</sup> *Po aty*, Nr.363.

<sup>48</sup> *Po aty*.

<sup>49</sup> *Francë, Dokumente diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-'14, II nr.395, Pichon për Paul Combon, 15 Korrik 1913.*

të Shqipërisë, i instruktuar që të linte Korçën, Stylosin dhe ishullin e Sazanit Shqipërisë si dhe të neutralizonte kanalën e Korfuzit <sup>50</sup>.

Nisur nga këto sugjerime më 11 gusht, konferenca adoptoi një rezolutë diçka më të detajuar që merrej me çështjen e kufijve dhe punën e komisionit. Klauzolat më të rëndësishme të saj ishin si më poshtë:

1- Territori mbi të cilin do të shtrihej puna e komisionit duhej të ishte i përcaktuar qartë. Kufiri perëndimor do të ishte malet që ndajnë rajonin bregdetar të mbetur në territorin shqiptar përfshirë edhe Ftelian; po kështu lugina e Gjirokastrës që shkon drejt verilindjes duke kapur linjën kufitare të Kazase së vjetër otomane të Korçës. Midis këtyre dy rajoneve, linja e përcaktuar dhe e paraqitur me memorandum nga M. Venizellos në Konferencë do të formonte kufirin jugor të provincës të paraqitur nga komisioni, ndërsa nisur nga jugu dhe juglindja ai do të shtrihej sipas linjës së propozuar prej Austro-Hungarisë dhe Italisë.

2- Ishte vendosur tashmë që krahina bregdetare e Fteliat përfshirë ishullin e Sazanit, rajoni i vendosur

<sup>50</sup> *Austro-Hungaria, Nota diplomatike për përfaqësitë në Ballkan, 1912-'13, nr.771, Mensdorff për Berchtoldin, 1 Gusht 1913.*

në veri të vijës greke si dhe kazaja e vjetër otomane e Korçës, me perëndimin dhe bregun jugor të liqenit të Ohrit... të formonin një pjesë integrale të Shqipërisë.

3- Komisioni do të fillonte punën e tij më 1 shtator dhe do të mbaronte atë më 30 nëntor 1913.

4- Për drejtimin e punës së tij, komisioni do të procedonte në seksione, duke marrë parasysh format natyrore të luginave.

5- Përcaktimi i kufijve do të bëhej mbi baza etnografike dhe gjeografike; gjuha e popullsisë do të ishte përcaktuese...; komisioni nuk do të merrte parasyshë përpjekjet për plebisht apo manifestime të tjera politike.

7- Evakuimi i trupave grek nga territoret e dhëna Shqipërisë do të fillonte një muaj pasi komisioni të përfundonte punën e tij.<sup>51</sup>

Më 12 gusht në Dhomën e Komunave, Sër Eduart Grey e diskutoi çështjen e Shqipërisë si njërën prej dy çështjeve kryesore mbi të cilat Fuqitë duhej të merreshin vesh "po qe se ato ishin për lidhje dhe miqësi me njëra-tjetrën dhe lokalizim të luftës". Sa për çështjen e kufijve ato ishin ndeshur me

51. *Austro-Hungaria, Nota diplomatike dërguar përfaqësive në Ballkan 1913.13, nr.809, Berchtold për fon Braun, 12 Gusht, 1913.*

vështirësi të mëdha, por ata kishin arritur më në fund një marrveshje për një përcaktim të kufijve jugorë.

"Unë e kam të qartë (tha ai) se kur deklarata të përfundohet, ajo do të balafaqohet me kritikën e ashpër të çdonjërit që e njeh çështjen në terren dhe që e sheh atë vetëmn në kuadrin e e saj lokal.

Duhet mbajtur mirë parasyshë se duke bërë këtë marrveshje me një rëndësi të dorës së parë, qëllimi është të ruhet së pari marrveshja midis Fuqive të Mëdha dhe, nëqoftë se marrveshja për Shqipërinë e ka siguruar këtë, ajo ka bërë punën më esencjalje për interesat e paqes së Evropës".<sup>52</sup>

Në këtë mënyrë, Konferenca e Ambasadorëve në Londër e zgjidhi në pamje problemin e vështirë të kufijve greko-shqiptar. Austro-Hungaria dhe Italia arritën kështu një sukses duke ndërtuar një shtet të pavarur shqiptar.

Megjithatë politika e shtrirjes së kufijve, u ballafaqua me kundërshtimin e grekëve, të cilët

52. *Debate parlamentare, 1913, LVI, 2282 ff. Për pjesën e Sër Eduard Greyt dhe për një përmbledhje të qëndrimit të marrë prej vendeve të ndryshme në Konferencën, Lichmoësky, Misioni im në Londër, f.6-11 ku ai tha se Franca e mbështet Greqinë, që Gjermania mori anën e Austro-Hungarisë dhe Italisë, ndërsa Sër Eduart Grey, për të mos i shtënë benzinë luftës, mbështeti fort kërkesat franceze dhe ruse.*

kërkonin zgjerim teritoresh drejt veriut, kryesisht me arsyetime etnologjike dhe strategjike. Për këtë Greqia gëzonte mbështetjen e Francës. Një kompromis midis dy pikpamjeve ishte i domosdoshëm për të ruajtur paqen në Europë. Përkisht për të përcaktuar me saktësi këtë vijë kufitare kompromisi, u ngrit një komision. Baza ku do të mbështetej puna e tij ishte gjuha e folur e banorëve, një bazë e cila në një vend ku fliten dy gjuhë ishte e mbushur plot me rreziqe, rrjedhojat e të cilave dolën shumë shpejt në pah.

Zgjidhja e problemit shqiptar u bë në Konferencën e Ambasadorëve duke arritur në përcaktimin e kufijve jugorë të këtij shteti të ri në aspektet e tij më të gjëra dhe formimin e një komisioni, i cili do t'i përcaktonte kufijtë në mënyrë të detajuar në vend. Çështja ishte zgjidhur nëpërmjet një kompromisi të pranueshëm, edhe pse jo krejtësisht të kënaqshëm për fuqitë që e kishin arritur atë. Tani ajo çfarë mbetej të bëhej ishte që vendimi të vihej në jetë. Fatkeqësisht, këtu Fuqitë po i bënin llogaritë pa hanxhinë, sepse piksepari nuk kishin marrë parasysh dëshirat e popullsisë së interesuar për këtë çështje. Ky gabim dyfishohej po të kishim parasysh vështirësitë gati të pakapërcyeshme për të përcaktuar

gjuhën në atë vënd dygjuhëfolës.

Komisioni vonoi që të mblidhej. Mbledhja e hapjes u mbajt më 4 tetor, një muaj më vonë se sa ishte planifikuar. Instruksionet e detajuara të dhëna nga Vjena për delegacionin Austro-Hungarez, mishëronin pikëpamjet austriake për kufijtë gjuhësorë dhe ishin të shoqëruara me një hartë e cila paraqiste grafikisht territorin e lënë për punën e komisionit, një përshkrim të kufirit greko-shqiptar, ashtu siç e kishte kërkuar Greqia në memorendumin e Venizellosit dhe një deklaratë rreth linjës së kompromisit, siç ishte përpunuar prej Austro-Hungarisë dhe Italisë. Monarkia Dualiste përkrahte tërheqjen e kufijve të paktën 12 km në jug të Gjirokastrës. Argumentet e paraqitura në mbështetje të kësaj ideje arsyetoheshin kështu: së pari krahina bregdetare e premtuar për Shqipërinë do të ishte proporcionalisht tejet e ngushtë nëse Lugina e Gjirokastrës do t'i jepej një vendi tjetër; së dyti rruga prej Delvinës për në Gjirokastrë duhej të mbetej shqiptare në tërësinë e saj dhe së treti që Gjirokastra është një qendër industriale për luginën dhe Saranda, porti nëpërmjet të cilit i tërë territori komunikon me botën e jashtme.<sup>53</sup>

<sup>53</sup> *Austro-Hungaria, Nota diplomatike dërguar përfaqësive të vendet ballkanike, 1912-'13, nr839.*

Fuqitë e njoftuan Shqipërinë mbi vendimin për vendosjen e Korçës nën pushtetin e saj. Ata njoftuan gjithashtu Greqinë dhe kur grekën në Korçë u përpoqën të organizonin kundërshtime lokale ndaj përfshirjes në shtetin shqiptar, Austro-Hungaria dhe Italia e paralajmëruan Greqinë që të mos i mbështeste këto kundërshtime<sup>54</sup>. Greqia nga ana e saj e informoi Bertoldin, nëpërmjet ministrit Austro-Hungarez në Athinë, që ajo u kishte dhënë urdhëra shumë të rrepta autoriteteve lokale në Epir që komisioni i kufijve jugore të Shqipërisë të mos pengohej në punën e tij.<sup>55</sup>

Komisioni në mbledhjen e tij të parë më 4 tetor në Manastir vendosi rregullat procedurale që do të ndiqeshin. Një ndër rregullat procedurale ishte që

54. Po aty, nr.860, Berthold për Ambasadorët në Berlin, Londër, Paris dhe Shën Peterburg. 8 shtator 1913.

55. Po aty, nr.869, Fustenberg për Berchtoldin, 16 shtator 1913. Komisioni i kufijve përbëhej si më poshtë: Për Anglinë, Kolonel-leitnant Doughtly-Juile, ish konsull në Adana dhe mbajtës i të njëjtës pozitë në Adis Abeba, i ndihmuar prej Captain King, R.E. për punë topografike; për Francën, Leitnant Kolonel Lellemend i artilerisë franceze, dhe M.Krauer, zëvendës-konsull në Volo, për Rusinë, Kolonel Gouten, atashë ushtarak në Athinë, për Gjermaninë, Leitnant Kolonel Tirrey i Shtabit të përgjithshëm; për Austro-Hungarinë, Herr Bilinski dhe herr Buchberger, të cilët kishin mbajtur postet e konsujve të përgjithshëm dhe zëvendës konsujve respektivisht në Janinë; për italianë, sinjor Labia, i ash konsull i italisian në Janinë i ndihmuar nga kapiten Castoldi. Shih, Lidhja Anglo-Helenike, Muarry, Epiri i Veriut më 1913.f.4.

komisioni të refuzonte t'i vinte veshin ndonjë delegacioni grek ose shqiptar për çfardo që ata mund t'i paraqisnin komisionit; gjatë shqyrtimit në zona të ndryshme komisioni do të refuzonte të shoqërohej qoftë prej civilësh grekë ose shqiptarsë, qoftë prej ushtarakësh, dhe që ndonjë shoqërues i nevojshëm do të rrinte dhe të priste në hyrjen e fshatit ku ata do të futeshin; që shërbimi i personave privat nuk do të pranohej; vendimi për të vizituar qytetin tjetër duhej marrë pasi të largoheshin nga qyteti i mëparshëm; diskutimet që kishin natyrë diplomatike duhej të mbaheshin sekret; qeveria greke duhej të informohej për këto vendime sipas procedurës së radhës; autoriteteve pushtuese iu duhej kërkuar që të mos e besdisnin komisionin.<sup>56</sup> Klauzola e fundit kishte parasysh Greqinë dhe kishte frikë se mos mbreteria e saj e nxiste pjesen greke të popullatës të bente rezistencë ndaj përfshirjes së saj me Shqipërinë. Ankesat për veshtirësitë me të cilat ishte ballafaquar komisioni i bëri të njohura Greqisë me 31 tetor nga Austro-Hungaria dhe Italia me nota të posaçme. Me tone kercenuese të dyja Fuqitë e informuan Greqinë se perfaqësuesit e tyre ne

56. Austro-Hungaria, Nota diplomatike për perfaqësitë në vendet ballkanike, 1912-1913, nr 896, Bilinski për Berchtoldin, 5 tetor 1913.

komision ishin instruktuar që të vlerësonin si shqiptare të tëra fshatrat ku do të ndesheshin me kundërshtime.<sup>57</sup> Ata shtuan se qeveritë i bashkoheshin kushteve të shtruarra prej ambasadorëve në Londër në lidhje me qendrueshmerinë e komisionit dhe evakuimin e ushtrisë greke prej teritoreve, tashmë, të caktuara për Shqipërinë.<sup>58</sup>

Irritimi që shkaktoi kjo notë nuk mbeti vetëm në Greqi, pasi dhe Fuqitë tjera të Mëdha kishin qenë tërësisht të panjohura me idenë e një veprimi të tillë të ndermarrë prej kolegëve austro-hungarezë e italianë. Alarmi ndaj këtij veprimi të pavarur nga palët e Ballplatzit dhe të Consultes ishin shprehur dhe prej Francës dhe prej Anglisë, kur "Times" e Londres e karakterozonte një veprim të tillë si "jo të pershtatshëm e madje shqetësues", bazuar në atë që kjo tregonte një prirje për ta trajtuar Shqipërinë si një rezervat Austro-Hungarez.<sup>59</sup> Incidenti, theksohej gjithashtu, ngjyrosi raportet mbi dallimet serioze të opinionit midis anëtarëve të komisionit, perderisa ankesa Austro-Hungareze kundër zyrtarëve grekë kontrastonte çuditshëm me falenderimet e fundit të

57 *New York Times*, 2 nëntor 1913.

58. *Le Temps*, 3 dhe 4 nëntor 1913; *The Times*, (Londër), 3 nëntor 1913.

59. *The Times* (Londër) 3 nëntor 1913.

majorit Doghty-Wylie mbi lehtësirat që i ishin dhënë komisionit.<sup>60</sup>

Qeveria greke, nga ana e saj na terhoqi vemendjen Fuqive të Mëdha ndaj faktit se ajo, jo vetëm që nuk e kishte penguar komisionin në punën e tij, por perkundrazi kishte bërë gjithçka të mundur për ta ndihmuar.<sup>61</sup> Sadoqë pergjigja greke ruhej nga të qenit një protestë e thatë kundër veprimit të njëanshëm të dy fuqive të Aleancës Trepalëshe, nota helenike e bentë atë të qartë, sipas *The Times*, qeveria Greke kujdesej më shumë ndaj instruksioneve të Konferencës së Ambasadorëve se sa ndaj atyre që vinin nga Roma apo Vjena. Për shtyrjen gjashtë javë për fillimin e punës së komisionit, qeveria greke, shtonte *The Times*, mund "të kishte përgjegjësi të rëndë"<sup>62</sup>.

Komisioni nuk u largua prej Manastirit për të filluar punën deri në 14 Tetor<sup>63</sup>. Sipas vlerësimeve të bëra prej përfaqësuesve të shtypit, të cilët e shoqëronin komisionin, ky i fundit qëndroi në fshatin e Ersekës për njëzet e dy ditë, kohë gjatë së cilës ata vizituan vetëm gjashtë fshatra dhe takuan

60. *The times*, (Londër), 3 nëntor 1913.

61. *Po aty*, 4 nëntor 1913.

62. *Po aty*, 6 nëntor 1913.

63. *Po aty*

vetëm rreth nja njëzet vetë me qëllim që të verifikonin gjuhën që flisnin banorët e asaj anë. Nisur nga ato pak njohuri që gjenden rreth veprimtarisë së komisionit, del e qartë rruga pa krye ku kishte hyrë çështja; delegatët u rreshtuan në dy kampe; ata të Alencës Trepalëshe përkrahnin atë që krahinat shqiptare, ndërsa Treshja e Antantës mori kahje tjetër, pra megjithëse gjeneratat e moshuara në një numër fshatrash flisnin shqip, tërë gjenerata e re vlerësohej prej tyre si greke në jetën e vet intelektuale, në ndjenjat dhe aspiratat e tyre.<sup>64</sup> Ndërsa komisioni në një amulli të plotë priste në Leskovik, Major Doughty-Wyile i propozonte Londrës telegrafisht që bisedimet të proçedonin mbi një bazë tjetër. Kur propozimi i tij i parë, i cili në dukje caktonte pika të qarta ndaj Greqisë, dështoi të fitonte pëlqimin e Austro-Hungarisë dhe të Italisë, ai sygjeroi një kompromis të dytë sipas të cilit, me qënë se nuk kishte baza të plota gjuhësore, duhej vepruar mbi baza gjeografike, ekonomike dhe strategjike.<sup>65</sup>

Megjithëse vdekja e Bilinskit, delegatit Austro-Hungarez, vendin e të cilit Vjena premtoi se do ta plotësonte me një njeri më të paanshëm, i dha më

64. De Jessen, *Le Temps*, 13 nëntor 1913.

65. *Le Temps*, 9-15 nëntor 1913, Dillon, *Revista Bashkëkohore*. (1913) CIV, 879-80.

shumë mundësi adaptimit të një kompromisi, prapsepapë kompromisi i propozuar përjetoi keqas shumë ndryshime në Londër përpara se të arrihej deri tek një marrveshje.<sup>66</sup> Por prapsepapë një kompromis i thjeshtë nuk ishte i pranueshëm, për epiriotët; dhe, siç deklaronte një vëzhgues, pakënaqësia e tyre ishte e tillë sa që një ditë do të çonte në një rezistencë të pashmangshme. Venizellosi gjithashtu ishte i pakënaqur. Ai i deklaroi Parlamentit Grek se nuk ishte i lidhur me detyrime zyrtare ndaj Konferencës së Londrës, një argument ky i bazuar në faktin se ai u kishte thënë fuqive që më parë, në rrjedhat e bisedimeve në Londër, se kufiri ekstrem i lëshimeve greke në bregdet ishte mbajtja e Korçës, Gjirokastrës dhe Përmetit nga Greqia. Në vijim të saj, pak ditë më vonë, qeveria greke paraqiti nëpërmjet përfaqësuesve të vet jashtë vendit, një ekspozitë të re, më të detajuar, të rezultateve shkatërrimtare që do të sillte kompromisi i propozuar.<sup>67</sup>

Pas shtyrjes së mëtejshme, Sër Eduard Grey doli me një propozim përfundimtar lidhur në çështjet e Shqipërisë dhe të ishujve. Duke i kërkuar Konferencës

66. *Le Temps*, 24 nëntor 1913.

67. *Po aby*, 27-28 nëntor, 4 dhjetor 1913. Duhet kujtuar që shtypi francez në përgjithësi dhe *le Temps* në veçanti ishte fuqimisht pro-grek

së Londrësë vendimin që puna e Komisionit të përcaktimit të kufijve duhet të përfundonte më 30 nëntor dhe që territori i okupuar prej grekëve duhej evokuar një muaj më pas, ai sugjeroi që përderisa komisioni nuk e kishte përfunduar punën e tij dhe për rrjedhojë, evakuimi brenda një muaji ishte i pamundur, domosdoshmërisht duheshin arritur disa marrveshje. Pra sipas kompomisit të propozuar, vija kufitare do të shkonte bashkë me lumin Sarandaporos atu ku ai lidhej me lumin Vjosa dhe prej andej do të vijonte me kufirin jugor të zonës së debatueshme për t'ju bashkuar kufijve të vendosur që zgjatëshin brenda territorit nga gjiri i Ftelias. Kjo vijë ia linte Korçën Greqisë por nuk përfshinte një numër fshatrash grekë, Në komunikimin me qeverinë Britanike rreth këtij subjekti, kabineti i Athinës pretendonte se Greqia në këtë mënyrë do të humbiste 140.000 greke dhe theksonte se kufiri i ri ishte tërhequr arbitrarisht në mënyrë të tillë që t'ja linte të gjitha pikat strategjike Shqipërisë, pa bërë vlerësimin e nevojshëm për kushtet lokale ose komunikimin; megjithatë nota greke nuk paraqiste ndonjë rezistencë të fortë ndaj dëshirës së Evropës<sup>69</sup>.

69. *Le Temps*, 5 dhjetor 1913 (tekst i pathënë; korrespondencë nga Berlini) *The Times* (Londra), 5 Dhjetor 1913.

Ndërkohë komisioni e kishte lënë Shqipërinë Jugore dhe ishte larguar për në Itali. Më 20 dhjetor erdhi njoftimi se Komisioni kishte pranuar më 17 dhjetor linjën e propozuar prej Britanisë së Madhe in toto, Ky vendim njihet si protokoll i Firences dhe merr emrin nga qyteti ku u bë veprimi zyrtar<sup>70</sup>. Kufijtë, siç ishin përcaktuar tashmë, fillonin prej pikës më jugore të vijës së vendosur më 11 gusht; më pas ajo vijonte drejt jugperëndimit për tek Mali Kazan në vargmalin e Gramozit, kreshta e të cilit shkonte deri tek Mavripetra; prej këndej kufiri i ri përplasej kryq me lumin Sarandaporos (në veri të Korçës), rrjedha e të cilit formonte kufijtë deri ku bashkohej me Vjosën, prej nga vija përafërsisht shoqëronte kufijtë jugorë të zonës së debatueshme për tu bashkuar me fudin e kufijve të vendosur më 11 gusht. pra në brendësi të vendit duke filluar nga gjiri i Ftelias. Sipas këtyre kufijve, lugina dhe qyteti i Gjirokastrës, Leskoviku, Delvina, Saranda, Tepelena, Përmeti, Korça, dhe Kepi i Stillos përfshiheshin brenda Shqipërisë.<sup>71</sup>

Megjithëse Protokoll i Firencës i vendosi kufijtë jugorë të Shqipërisë, të cilët u kishin shkaktuar

70. *Po aty*.

71. *Po aty*, 20 Dhjetor 1913, *Le Temps* e të njëjtës ditë.

Fuqive shumë shqetësime, u deshën afro dy muaj derisa gjashtë Fuqitë të merreshin vesh për t'i dërguar një note qeverisë greke rreth çështjeve të ishujve të Egjeut dhe të Epirit. Kjo note njoftonte që afërsisht tërë ishujt do t'i jepeshin Greqisë në se trupat greke do të largoheshin prej territoreve të lëna për Shqipërinë, dhe që qeveria greke vetë, as të mos rezistonte e as të mos nxiste ndonjë lloj rezistence ndaj atyre çfarë ishin vendosur nga Fuqitë për Shqipërinë Jugore.

Evakuimi duhej të fillonte më 1 mars me tërheqjen e trupave greke nga kazaja e Korçës dhe do të procedonte me mënyrë të njëpasnjëshme të gjitha pikat e tjera deri më 31 mars, kohë kur do të shënohej largimi i plotë i trupave greke nga kazaja e Delvinës.<sup>72</sup>

Në përgjigje të këtij komunikimi tejet të vonuar, qeveria greke shprehu gadishmërinë e saj për t'u pajtuar me vendimin e Fuqive dhe pranoi të urdhëronte trupat që të lëshonin territoret e dhëna Shqipërisë brenda kohës së caktuar. Greqia vendosi të mos kundërshtonte evakuimin, por sugjeroi që fshatra të tëra në luginën e Gjirokastrës i duheshin dhënë asaj, në këmbim të shtrirjes së territorit

72. Për tekst, shih *Le Temps*, 15 shkurt 1914.

shqiptar gjatë bregdetit si dhe të një pagese prej 2.500.000 franga.

Nota shkonte edhe më tej kur sygjeronte që popullsia epirote duhej të qetësohej nga frika e garantimit të institucioneve të saj. Gjatë procesit të evakuimit dhe në periudhën e vështirë më pas, duheshin marrë masa për të risiguruar njerëzit që pasuria e tyre nuk ishte në rrezik. Një aneks përmbante një ratifikim të sygjeruar për kufijtë në Korçë.<sup>73</sup>

Shumë shpejt u përhapën thashetheme se elementë të caktuar në popullatën epirote ishin duke bërë rezistencë me arme ndaj përfshirjes së tyre në Shqipëri. Më 16 shkurt qeverisë britanike iu kërkua të spjegonte në Dhomën e Komunave: "Nëqoftëse shihet se banorët e krahinës e kanë kundërshtuar një përfshirje të tillë dhe janë të vendosur për ta kundërshtuar atë me forcën e armëve, a është e përgatitur Qeveria e Madhërisë së saj që të pranojë shtrëngimin që rrjedh

73. Për tekst shih, po aty 23 Shkurt 1914. Disa prej këtyre sygjerimeve ishin rezultat i një turri nëpër kryeqytetet evropiane të Venizellosit në dhjetor të viti 1913. Shih *The Times* (Londër) 16 shkurt 1914. Gjatë tërë periudhës së diskutimit Lidhja Anglo-Helenike e themeluar në atë kohë për të forcuar ndjenjat tradicionale britanike për filohelenizmin-ishte aktive. Për shprehjen e opinionit në Dhomën e Komunave, shih ato të Mr.R.P.O'Connor, 29 Maj 1913; "A mund të ketë gjë më monstruoze ose absurde se sa të vendosësh këtë popullatë të gjërë greke nën kontrollin e një race tjetër?"

prej këtij kundërshtimi?" Nënsekretari i shtetit për punën e jashtme, duke iu referuar komunikimit të vazhdueshëm me qeverinë greke në përgjigje të kësaj pyetje besonte "se asnjë çështje për masa shtrënguese nuk do të ngrihej"<sup>74</sup>. Por popullsia e Gjirokastrës shpresonte tek rishikimi i kufijve të krahinës së saj, siç ishte kërkuar në notën greke të 21 shkurtit. Veçanërisht inkurajuese ishte vizita e Venizellosit në kryeqytetet evropiane, ku Ministrit grek i ishte lënë të shpresonte për mundësinë e një rishikimi të tillë që të plotësoheshin aspiratat greke me një numër të caktuar fshatrash afër Gjirokastrës. Kur ky lajm iu bë i njohur popullsisë, shpresat e saj u forcuan.<sup>75</sup>

Ndërkohë mori formë rritja e lëvizjes për rezistencë ndaj përfshirjes me Shqipërinë. Javët në vijim dëshmuuan shpalljen e autonomisë së Epirit në Himarë, Gjirokastrë, Sarandë dhe Delvinë, "përkundër keshillave për ta shtyrë atë, të afruara nga udhëheqësit shqiptarë."<sup>76</sup> Lëvizja autonomiste

*Gjithashtu ajo e Mr. Walter Guinness, 8 maj "Greqia kërkonte territore të Shqipërisë Jugore ku raca shqiptare është në shumicë absolute" Debate parlamentare, (1913) LIII, 371; LII, 1304. Për opinionin francez bashkëkohor, shih Le Temps, 8 dhjetor dhe 12 prill 1913 (në favor të plebishitit)*

74. Debate parlamentare. Commons (1914) LVII, 550.

75. Le Temps, 4 mars 1914.

76. The Times (Londër) 25 shkurt 1914. Le Temps, 26 shkurt, 4 mars.

mori formën e vet të plotë, kur më 28 shkurt lajmi se udhëheqësi grek Zografos ishte emëruar si president i qeverisë provizore të Epirit autonom në një tubim publik në Gjirokastrë i ishte bërë i njohur Durrësit, vendit ku ishte vendosur Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, organ i ngritur nga ana e Fuqive për të qeverisur Shqipërinë, me sundimtar të zgjedhur më në fund, princin gjerman Vilhelm Vidi<sup>77</sup>. Kur u shpall pavarësia e Epirit të Veriut më 2 mars në Gjirokastrë, Zografosi mbajti një fjalim kur deklaroi pamundësinë e nënshtrimit ndaj zgjedhës së një populli barbar dhe shtoi, dramatikisht, se epiriotët, të pazot për të përmbushur endrrën pesë shekullore, kishin vendosur që të vdisnin për lirinë e tyre.<sup>78</sup>

Lëvizja e autonomisë në Epirin e Veriut u kryesua prej Zografosit dhe Karapanos, të cilët paraqitën vetveten "si një komitet ekzekutiv me funksionet e një qeverie provizore".<sup>79</sup> Politika e Zografosit në fillim ishte shpalosur nëpërmjet deklaratave të bëra në vigjilje të nisjes së tij nga Athina për në Gjirokastrë. Lëvizja, deklarohet ai, ishte provokuar

77. Debate parlamentare. (1914) LIX, 852.

78. Le Temps, 5 mars 1914.

79. Lidhja anglo-helenike. Nr.10.f.7. Për shpalljen e bërë prej qeverisë autonome të Epirit, shih Le Temps, 9 mars 1914.

prej nevojës për të mbrojtur ekzistencën e popullsisë epiriote. Në pikpamjen e tij ekzistonin tre mënyra për mbrojtjen e popullsisë prej rrënimit fatal: e para, autonomi e plotë nën skeptrin e princit të Shqipërisë; e dyta, një autonomi shumë e gjërë administrative ose kantonale e bazuar në një xhandarmëri të rekrutuar posaçërisht midis njerëzve të krahinës në fjalë; dhe e treta, pushtim evropian dhe administrim plotësisht i mjaftueshëm për të qartësuar të vërtetën mbi situatën dhe që duhej të zgjaste deri sa tërheqja të mos shkaktonte rreziqe. “Në qoftë se Europa dëshiron që të shmangë fatkeqësinë e të lenurit prapa të tymit dhe rrënojave të invadorëve shqiptarë, ajo duhet të ndërhyjë në kohë, për të marrë masa të cilat, pa modifikuar bazat e vendimiit të Fuqive, do të siguronte një popull dhe ruante principet e humanizmit”.<sup>80</sup>

Pozita e qeverisë greke gjatë revolucionit në Epirin e Veriut ishte e një natyre të pa anshme. Me nxitim, më 9 mars, u deklarua një bllokadë e portit të Sarandës, “tani në dorën e kryengritësve”<sup>81</sup>. Qeveria greke, në fakt, ndaloi një demonstratë në Athinë të organizuar prej Partisë Punëtore në favor të

80. *Le Temps*, 3 mars 1914.

81. *Gazetat shtetërore dhe të huaja britanike, pjesa e parë 1914*. CVII, 137

epiriotëve; thuhet që ky përbën rastin e parë që demonstrata të tilla të ishin ndaluar në Greqi<sup>82</sup>. Se sa larg shkoi qeveria greke në përpjekje për të ruajtur një qëndrim korrekt tregohet në deklaratën e Zografosit, i cili vetë tha se ai kishte shkaktuar armiqësinë e qarqeve zyrtare të Athinës dhe që qeveria kishte “keqkuptuar në mënyrë të çuditshme shkallën e detyrimeve të veta ndaj Fuqive. Ajo ka bllokuar Sarandën, duke penguar furnizimet dhe ardhjen e ushqimeve të ushtarëve tanë. Janë lëshuar urdhëra për ndalimin e oficerëve, ushtarëve dhe të tjerëve nga të ardhurit në ndihmë për ne. Tregtarët janë paralajmëruar që të mos na furnizonin me armë dhe municione. Dërgesat, madje edhe letrat private janë hapur e kontrolluar.”<sup>83</sup>

Sa i takonte qëndrimin të qeverisë greke, shefi i shtabit i forcave epiriote kolonel Doulis, ia nënshtroi komisionin e tij ushtrisë helenike, përpara se të bashkoheshin revolucionarëve në Epir.<sup>84</sup> Ideja se mos qeveria greke kishte inkurajuar në ndonjë mënyrë lëvizjen revolucionare u kundërshtua formalisht prej ministrit grek në Londër, Gennadius, i cili vepronte sipas instruksioneve të marra nga

82. *The Times (Londër)* 23 mars 1914

83. *Lidhja anglo-helenike*, nr.10.f.13.

84. *Le Temps*, 24 mars 1914.

Athina. Ai deklaroi se si rezultat i masave të marra prej qeverisë, ai i kishte tendosur marrdhëniet e tij me Zografosin deri në një pikë thyerje, pa përmendur këtu ndjenjat që zgjoi në vetë Greqinë. Kështu ai me së fundi theksoi konditat e vajtueshme, për të cilat kishte arsye të plota për tu frikësuar, e që do të bëheshin shumë shpejt edhe më keq, por që nuk do të ishin të tilla po t'u ishte kushtuar vëmendje sugjeimëve të bëra në notën greke të 21 shkurtit<sup>85</sup>.

Njëra prej arsyeve kryesore të revoltës qëndronte padyshim tek pazotësia e dukshme e Fuqive për t'i dhënë një përgjigje përfundimtare kërkesave greke. Fuqitë, sado që ishin të informuara prej qeverisë greke që graviteti i situatës kërkonte një vendim urgjent dhe se metoda e evakuimit ishte e pakënaqshme po të kihej parasyshë paaftësia e xhandarmnërisë shqiptare për të ruajtur rendin,<sup>86</sup> vazhdonin të mos kthenin përgjigje. Ndjenjat në Epir ishin aq të forta sa evakuimi i ballafaqonte në të vërtetë ministrat grekë me një seri problemesh; ata e konsideronin evakuimin e krahinave pa

<sup>85</sup> *The Times* (Londër) 20 Prill 1914, rishtypur në Lidhjen anglo-helenike, nr.10 prill, f.1. Për më shumë mospranim të bashkëpunimit midis Gjirokastrës dhe Athinës shih de Jassen në *Le Temps*, 23 prill 1914; gjithashtu *The Times* (Londër), 17 prill, 1914.

<sup>86</sup> *Le Temps*, 15 mars, 23 prill 1914

formalitetet e nevojshme, si një ballafaqim të trupave greke me mundësinë e dezertimit ose të goditjes mbi vëllezërit e tyre. Ndërkohë që të dyja, Korça dhe Moschopolis, iu kthyen xhandarëve shqiptarë nën komandën e oficerëve danezë<sup>87</sup>, por evakuimi i krahinave të mbetura u shty në pritje të një përgjigje të favorshme nga Fuqitë. Një përgjigje Austro-Italiane, paraqitja e të cilës deklarohet se ishte bërë për shkak të një keqkuptimi, pasi Aleanca Trepalëshe nuk kishte patur për qëllim që të ndante veten nga ujdia me Evropën në këtë çështje, pranonte ratifikimin e Gjirokastrës, por jo të Korçës. E megjithatë karakteri i saj i përgjithshëm, thjeshtë iu konfirmonte ekstremistëve besimin e tyre që autonomia e plotë ishte e vetmja zgjidhje e mundshme.<sup>88</sup> Qeveria e Athinës edhe më tej shpërndau një note tek përfaqësuesit e Fuqive më 30 mars, duke kërkuar që në momentin kur trupat helenike të përqëndroheshin për t'u evakuuar, Fuqitë nuk duhej të çmonin atë si një rast të volitshëm për të dhënë një përgjigje në lidhje me garancitë e kërkuara për popullatën epirote në komunikatën greke të 21 shkurtit<sup>89</sup>. Shtyrja që Fuqitë i bënë

<sup>87</sup> *The Times*, (Londër) 18 mars 1914; *Le Temps*, 4,18,19, mars 1914.

<sup>88</sup> *Le Temps*, 14 mars 1914.

<sup>89</sup> *The Times* (Londër) 31 mars 1914.

përgatitjes së kësaj përgjigje u kthye në një çështje politike në Domën e Komunëve të Britanisë, Sër Eduart Grey tha më 2 prill se evakuimi, për t'u kryer plotësisht deri më 31 mars, duhej të fillonte deri brenda pak ditësh, kur qeveria greke u sugjeroi Fuqive dëshirën për të shtyrë tërheqjen e trupave të tyre në interes të rendit publik, duke zgjatur kështu përfundimin e bisedimeve midis qeverive shqiptare dhe qeverisë së përkohëshme të "Epirit të Veriut". Deri sot asnjë përgjigje nuk iu kthye atij propozimi.<sup>90</sup>

Bisedimet që patën si subjekt përgjigjen vazhduan në një përpjekje për të ardhur tek një marrveshje midis Fuqive, dhe më së fundi, përgjigja e propozuar prej tre fuqive të Antantës, u pranua prej Aleancës trepalëshe, kështu që më 24 prill, Fuqitë i dhanë një përgjigje notës greke të 21 shkurtit.<sup>91</sup>

Kjo komunikatë deklaronte se Fuqitë ishin gati të ushtronin të gjithë influencën e tyre për të vënë në jetë principet e barazisë së plotë fetare dhe gjuhësore, tashmë të vendosura prej Komisionit të Kontrollit, dhe ishin të prirura për t'i rekomanduar Qeverisë Shqiptare që ajo të vlerësojë sugjerimin e Qeverisë Greke në lidhje me rekrutimin e elementeve lokale

90. *Debate parlamentare (1914) LX, 1320.*

91. *Po aty, 9 prill 1914. Momenndumi për Epirin e Veriut. f.21*

në xhandarmëri. Nota shkonte edhe më tej kur njoftonte se, nëse një marrveshje mund të zbatohet midis Fuqive të ndryshme dhe Greqisë në rajonin e Gjirokastrës, ata ishin gati ta vinin atë në jetë, por duheshin bërë vëzhgime për të parë nëse dëshirat e Qeverisë greke mund të pajtoheshin me linjën e adaptuar prej gjashtë Fuqive për Korçën<sup>92</sup>. Rezultat i kësaj komunikate ishte përsheptimi i menjëhershëm i evakuimit, i cili përfundoi më 28 prill, pesë muaj pas kohës së caktuar për këtë.<sup>93</sup> Një përgjigje e shpejtë e Fuqive, do të ishte padyshim e efektshme për parandalimin e lëvizjes revolucionare, e cila kishte gjetur një terren të përshtatshëm pikërisht prej pasigurisë dhe ankthit të shkaktuara prej kësaj shtyrje.

Forcat revoluciste dhe ata të Shqipërisë vazhduan në luftë të parregullt, megjithëse Zografos i kishte dërguar më parë një paralajmërim Komisionit të kontrollit, duke kërcënuar se do të hakmerrej në qoftë se xhandarmëria shqiptare i tejkalonte kufijtë epirote.<sup>94</sup>

Në fund të marsit qeveria shqiptare iu kërkoi formalisht Fuqive që të vinin në veprim influencën

92. *Për tekst shih Le Temps, 26 prill 1914.*

93. *Po aty, 27, 28, 30 prill 1914.*

94. *The Times, (Londër) 12 mars 1914.*

e tyre ndaj Greqisë për t'i dhënë fund "situatës së mjerueshme" që ekzistonte në Epir, duke tërhequr vëmendjen për konfliktet e fundit dhe njoftoi gjithashtu se, megjithëse trupat greke po tërhiqeshin, vendin e tyre po e zinin bandat e comitadijis, të organizuara dhe të armatosura prej autoriteteve greke.<sup>95</sup> Të dyja palët raportnin për grabitje dhe brutalitet <sup>96</sup>. Në prill ushtria epirote, së cilës i shtoheshin çdo ditë rekrutë të rinj, thuhej se numëronte nja pesëmijë burra, shumica prej të cilëve ishin ish pjesmarrës në ushtrinë greke. Në mbështetje të këtyre trupave "të rregullt" ishin trupat e parregullta vullnetare në një numër thuajse të barabartë me ato "të rregulltat", me të cilat ato dalë nga dalë po shkriheshin.<sup>97</sup>

Programi për të cilin qeveria autonome e Epirit po luftonte, mishërohej në një listë kërkesash për garancitë dhe privilegjet e caktuara, që ia kishin paraqitur zyrtarisht qeverisë shqiptare. Këto kërkesa përfshinin administrimin prej dy drejtuesve të kombësisë zviceriane dhe daneze, ndërtimin e një asambleje formale të një modeli si ai i Kroacisë, përfshirjen e elementeve kristiane në xhandarmëri,

95. *Po aty*, 30 mars 1914.

96. *Debate parlamentare (1914) LX*, 5-6

97. *Lidhja anglo-helenike*, nr.10. f.10-11.

të cilët nuk do të duheshin të dërgoheshin jashtë Epirit, liri të plotë për shkollat greke, liri të plotë fetare, si dhe dhënia Himarës i të gjitha privilegjeve që ajo gëzonte nën sulltanin.<sup>98</sup>

Qeveria shqiptare ishte në prag të diskutimit me epirotët mbi një bazë të garancive të kënaqshme, megjithëse jo autonomi, kur Esat Pasha, Ministri Shqiptar i Luftës, filloi mobilizimin kundër kryengritësve. Megjithatë, masat e represionit, të propozuara prej tij, nuk arritën që të marrin miratimin e Komisionit të Kontrollit, i cili këshilloi bisedime dhe garanci ndaj lëshimeve të domosdoshme. Komisioneri Britanik, Lamp, veçanërisht, vendosi përpara qeverisë shqiptare kokëfortësinë e një përpjekje të tillë përballë pengesave si: ushtria e stërvitur keq, gjëndje e pakënaqshme e financave të shtetit të ri dhe rreziku i komplikimeve me Malin e Zi.<sup>99</sup> Këto këshilla binin më shumë në sy po të kemi parasyshë pazotësinë e shqiptarëve për të shtypur kryengritjen në rastet e konflikteve të përsëritura midis forcave shqiptare dhe epirote. Zografosi nga ana e tij, i impresionoi

98. *Për tekst shih Le Temps*, 28 mars 1914.

99. *Le Temps*, 29 mars 1914. *Afati i propozuar u pranua prej delegatit epirot. Po aty*, 30 mars 1914. *The Times (Londër)* 8 prill 1914; *Le Temps* 10 prill 1914.

vëzhguesit me përmbajtjen dhe dëshirën për të bërë një zgjidhje me mënyra paqësore. Ai insistoi vetëm në një autonomi administrative, jo në bashkimin me Greqinë.<sup>100</sup>

Megjithatë duhet thënë se vetë përmbajtja e tij nuk hasej në të njëjtën trajtë tek pasuesit e tij, të cilët ishin shumë më agresivë.

Bisedimet midis Shqipërisë dhe kryengritësve epirotë në të vërtetë nuk filluan deri në fillim të majit. Ndërprerja e armiqësive erdhi si rezultat i ndërhyrjes së Komisionit të Kontrollit, të cilët afuan një takim në Sarandë ose diku tjetër për të trajtuar garancitë e kërkuara, ekzekutimi i të cilave i duhej besuar Komisionit. Kur kjo ofertë u pranua, anëtarët e Komisionit u nisën për në Sarandë për tu takuar me Zografosin; por bisedimet përfundimtare filluan në ishullin e Korfuzit, larg prej skenës së veprimeve të drejtpërdrejta.<sup>101</sup>

Epirotët fillimisht luftuan për autonomi, Megjithatë përveç kërkesave të fillimit, ata tani kërkuan që qeveritari kryesor dhe zyrtarët e lartë në qytetet kryesore duhej të ishin kristianë ortodoksë, që epirotët nuk do të ishin subjekt i shërbimit

100. De Jessen në *Le Temps*, 23 Prill, 1 Maj 1914.

101. *Le Temps*, 8,9 maj 1914; gjithashtu po aty, 10 maj për komente më të plota prej shtypit grek në këtë ndërhyrje.

ushtarak madje as në kohë lufte, që liria fetare dhe arsimore e grekëve duhej të shtrihej deri në Vlorë e Durrës, dhe që porti i Sarandës dhe Himarës duhej të deklaroheshin të lirë. Garancitë e afuara prej anëtarëve të Komisionit të Kontrollit, nga ana tjetër, përfshinin: së pari, lirinë e komunitetit ortodoks, lirinë e komuniteteve ortodokse për të përdorur gjuhën greke në shkolla, por nevojën e shqipes në shkollat fillore; së dyti, një xhandarmëri të përbërë me preferencë burrat e krahinës; së treti, konstituimi i Korçës dhe Gjirokastrës si kantone administrative me vetqeverisje lokale por me këshilla të kryesuara prej prefektësh që përfaqësojnë qeverinë qendrore dhe të emëruar prej saj; dhe së katërti masa të caktuara për lëshimin përkohësisht, por menjëherë të Gjirokastrës.<sup>102</sup>

Frika, e cila kishte arritur deri në pasiguri se mos konferenca e Korfuzit do të shpërbëhej, apo se mos trupat austro-hungareze dhe italiane do të pushtonin Shqipërinë Jugore, i dhanë lehtësi të dyfishtë arritjes së një kompromisi.<sup>103</sup> Sidoqoftë, delegatët epirotë

102. Po aty, 17 prill, 11 maj 1914.

103. Shih *The Times* (Londër) 12 maj 1914 për njoftimin e qeverisë greke nga ana e prefektit të Janinës ndaj këtij efekti. Shih gjithashtu Laoy, *Dokumente sekreten f.71 për marrveshjen austro-italiane*, lidhur me Shqipërinë, 8 maj 1913.

dhe Komisioni i Kontrollit që përfaqësonin një shtet të ri shqiptar, nënshkruan më 17 maj 1914 një marrvëshje sigurimi ndaj kërkesave kryesore të epiriotëve.

Sipas pikave të marrvëshjes së Korfuzit, epiriotët e përftuan autonominë për të cilën ata kishin luftuar. Ruajtja dhe zbatimi i organizimit paraprak iu besua komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, siç iu besua edhe organizimi i administratës publike dhe departamentit të drejtësisë e financës në provincën autonome të "Epirit të Veriut". Qeveria shqiptare, në marrvëshje me Komisionin e Kontrollit, kishte fuqinë për të emëruar dhe shkarkuar qeveritarët dhe zyrtarët e lartë, të cilët duhej të zgjidheshin në përpjestim me përkatësinë fetare. Komisioni kishte gjithashtu për detyrë mbikqyrjen e përcaktimit dhe ndarjes së dy krahinave të Korçës dhe Gjirokastrës prej të cilave përbëhej "Epiri i Veriut"; nëse ndonjëherë do të zgjidhej çështja e këtyre kufijve, ajo nuk mund të modifikohej pa pranimin e Fuqive. Një klauzole e veçantë i kushtohej xhandarmërisë lokale, e cila duhej të përbëhej nga pjesëmarrës me fe të ndryshme në proporcion me numrin e tyre, dhe të shërbenin jashtë provincës vetëm për një periudhë të caktuar dhe, vetëm në raste force

majeure, siç cilësohej prej komisionit. Ndalohej përdorimi i njësisve ushtarake jo-vendase në krahinat jugore, me përjashtim në raste lufte ose revolucioni; njihej e drejta e komuniteteve ortodokse; në këto komunitete, gjuha greke duhej të ishte gjuha e shkollës, por në të tria klasat e fillores shqipja duhej mësuar përkrah me atë greke me përjashtim të edukatës fetare, e cila duhej të ishte ekskluzivisht greke. Përdorimi i te dyja gjuhëve, asaj shqipe dhe greke duhej të ishte e sigurtë përpara të gjitha autoriteteve, duke përfshirë gjykatat dhe këshillat e zgjedhura. Nenet përmbyllëse të marrëveshjes siguronin një metodë specifike të punës, masa të posaçme përkrahje, amnesti të plotë për epiriotët, dhe një deklaratë të lëshuar si garanci për zbatimin e klauzolave të lartpërmendura prej Fuqive. Kësaj iu bashkangjiten dispozita të veçanta që kishin të bënin me Himarën, për të ruajtur privilegjet që gëzonte gjatë regjimit osman.<sup>104</sup> Marrvëshja e Korfuzit u ratifikua prej përfaqësuesve të Fuqive të mëdha në Athinë më 18 qeshor dhe prej qeverisë shqiptare më 23 qershor.<sup>105</sup>

104. Për tekst shih *Greqia, Propoganda, delegacioni, Memorandumi mbi Epirin e Veriut. Apendiks No; Greqia përpara Konferencës së Paqes, Shoqëria amerikano-helenike. XXVIII.*

105. *Frangulis, Çështja e Epirit të Veriut në Konferencën e Paqes f.17,18.*

Duke garantuar të drejtat e pakicës greke në shtetin e ri shqiptar, marrveshja e Korfuzit siguroi në dukje, një zgjidhje të kënaqshme po të merren parasyshë vësatirësitë që kishin kërcënuar paqen e Europës nga mundësia e përfshirjes së Fuqive të Mëdha në këtë konflikt. Pranimi i një periudhe të tillë paqeje në mënyrë që marrëveshja të zbatohet pa ndërhyrjen e Mbretërisë Greke, mund të sillte një farë qëndrueshmërie. Por përpara se sa ajo të ratifikohet dhe po kështu, përpara se të jepej një gjykim i shëndoshë për të, shpërtheu Lufta e Madhe.

#### IV. Shqipëria Jugore dhe Lufta e Madhe

Që prej qershorit, të 1914-ës çështja Shqiptare u bë një çështje shqetësuese për Evropën, kështu që shpërthim i luftës së madhe e gjeti Shqipërinë në një situatë tejte të paqëndrueshme<sup>1</sup>. Djegiet, ndjekjet, persekutimet, vazhdonin pa u ndaluar në "Epirin e Veriut". Qeveria qendrore shqiptare e princ Vidit, nuk ishte e zonja ta shtrinte autoritetin e saj jashtë Durrësit. Fatkeqësisht, në bashkëpunim me njerëzit e tij, për të cilën nuk është e nevojshme të flitet këtu, Princ Vidi, në fillim të shtatorit e la qetësisht vendin për të mos u kthyer kurrë. Si pasojë vendi ra në një ndarje, e cila i korespondonte konfiguracionit të saj gjeografik, secila pjesë për veten e vet nën një regjim të vetin dhe pikërisht siç përshkruhet më poshtë:<sup>2</sup>

1- Shkodra dhe rrethinat e saj nën një komision lokal.

2- Mirdita nën princin vendas, Preng Dode Biba.

3- Krahinat e banuara prej malsorëve nën prijësit

1. Jonescu, *Disa përshlypje personale* f.14.

2. *Data e saktë është e dhënë në variante të ndryshme.* 4. Shtator sipas *Temperly- t (botues), Një histori e Konferencës së Paqes në Paris, IV, 339;*  
3 Shtator, *Pavarësia e Shqipërisë 1 Nëntor 1915.*

e tyre.

4- Durrësi dhe rrethinat nën beun e krahinës, Esat Pashën.

5- Vlora dhe fqinjët përçark nën Komisionin e Kontrollit.<sup>3</sup> Gjatë viti të parë të luftës situata ndërkombëtare e Shqipërisë Jugore kushtëzohej nga fakti që Italia dhe Greqia, pra Fuqitë Mesdhetare, më të interesuarat për shtetin e ri, ishin neutrale. Interesi përqendrohej rreth përpjekjeve të bëra prej secilit nga të dyja kampet ndërluftuese për të mbajtur njërin ose tjetrën prej këtyre dy fuqive neutrale, jashtë luftës, ose për t'i tërhequr ato në anën e vet. Çelësi shpjegues i veprimit të Fuqive në Shqipëri gjatë kësaj periudhe të luftës gjendet tek vetë qëndrimi i tyre ndaj luftës në tërësi.

Në përpjekjet e dëshpëruara, të bëra prej Monarkisë Dualiste për të mbajtur neutrale, ish aleatën e vet Italinë, Shqipëria pat një ndikim shumë të madh.

Marrëveshja Austro-Italiane që kishte të bënte me Shqipërinë dhe që siguronte një veprim të përbashkët për të ruajtur paasnjësinë e saj<sup>4</sup>, teorikisht ishte ende në efekt, por në fillim të

3. *Manual page, nr.17, Albania f.72.*

4. *Shih supra, f.15*

shtatorit 1914 pati bisedime rreth një pushtimi italian të ishullit të Sazanit.<sup>5</sup> Bertoldit i ishte dhënë të kuptonte tërthorazi se një deklaratë publike mbi këtë e lëshuar prej Aleancës Treshe do të sillte rezultate të shkëlqyera” duke i bërë Fuqitë e Antantës të kuptonin se- “ndoshta si rezultat i hutimit të tyre”- Aleanca Treshe ishte ende në veprim. Bertoldi ra dakort me një pushtim të tillë, i cili duhej të njoftohej njëherazi në Vjenë, Berlin dhe Romë, por dëshironte që Italia të vlerësonte mirëkuptimin, pasi opinioni publik Austro-Hungarez ishte “veçanërisht i ndjeshëm ndaj të gjitha çështjeve që kishin të bënin me Shqipërinë”<sup>6</sup>.

Padyshim që Italia ishte duke kërkuar një pretekst për të pushtuar Vlorën, si mundësi për të kontrolluar Adriatikun. Në se mund të besohet në një raport Austro-Hungarez, Sgr.de Martino e diskutoi mundësinë e përdorimit të sulmeve të muhamedanëve mbi epiriotët për qëllime të provokimit të një pushtimi “epiriot” ose grek në Vlorë; në një rast të tillë qeveria italiane nuk mund

5. *Austro-Hungaria, Ministri i Punëve të Jashtme. Dokumente diplomatike në lidhje me marrëdhëniet e Austro-Hungarisë me Italinë nga 20 Qershori 1914 deri në 23 Maj 1915. Mercchio për Bertoldin, 11 shtator 1914; Gottfried Hohenlohe, për Berchtold, 12 shtator 1914.*

6. *Po aty, Berchtold për Hohenlohe, 6 shtator 1914.*

të mos përfillte opinionin publik i cili ishte jashtë mase i ndjeshëm në atë pikë.<sup>7</sup>

Shtetarët e Monarkisë Dyshe panë tek një ekspansion i mundshëm italian në Shqipëri, rrugën që Italia kishte zgjedhur si kompesim ndaj një ekspansioni të mundshëm të Austro-Hungarisë në Ballkan. Një ekspansion i tillë ishte i lidhur me të dyja, Monarkinë Dyshe dhe Italinë si një rast për të ndryshuar drejtimi i opinionit publik italian nga demonstrimet e armiqësisë ndaj Aleancës Treshe<sup>8</sup>.

*Ballplatz*<sup>9</sup>, veçanërisht frikësohej se kjo do t'i siguronte Italisë një rast për të futur një këmbë në Ballkan, gjoja për të ruajtur interesat e shteteve ballkanike nën drejtimin e saj në kohën e zgjidhjeve të mëdha të çështjeve<sup>10</sup>. Duke dëshmuar rrezikun e shkeljes së paasnjanësisë së Shqipërisë nga trupat Greke, *Consulta* i dërgoi një notë qarkulluese ambasadorit italian të akredituar tek nënshkruesit e protokollit të Londrës, në të cilën Forein Ofisi Italian theksonte besnikërinë e plotë ndaj protokollit si dhe shprehte qëllimin e Italisë, si e vetmja fuqi

7. Po aty, *Macchio* për *Berchtoldin*, 6 Tetor 1914.

8. Po aty, *Berchtold* për *Mercchio*, 9 Tetor 1914.

9. *Maccio* për *Berchtold*, 6 Tetor; *Berchtold* për *Maccio*, 22 Tetor 1914.

10. Po aty, *Maccio* për *Berchtold*, 6 tetor 1914.

neutrale midis të tjerave e cila mund të parandalonte përpjekjet e ndonjë ekspedite për të zbarkuar atje<sup>11</sup>. Prandaj ishte vendosur që të kishte një flotë ushtarake lundruese italiane në brigjet e detit shqiptar me qëllim që të parandalonte importet e armëve dhe municioneve të huaja.<sup>12</sup>

Në këtë pikë, Sër Eduard Grey, tërhoqi vëmëndjen e qeverisë italiane nëpërmjet ambasadorit britanik në Romë ndaj skamjes dhe mizeries që i kishte kapluar muahamedanët në Epir dhe rrjedhojat e rrezikshme që sillte masakrimi i popullsisë kristiane; qeveria autonome nuk do të ishte e aftë që të përballonte këtë situatë. Në këto rrethana Sër Eduard Grey ndjeu që ajo çfarë mund të bënte Venizellosi nuk ishte asgjë më pak se sa të dërgonte një regjiment drejt Gjirokastrës për të mënjanuar masakrat, duke premtuar se ato do të tërhiqeshin atëherë kur do të dëshironin fuqitë; ai deklaroi gjithashtu se qeveria greke do të pajtohej me një pushtim italian të Vlorës. Kryeministri italian, Salandra, ndërsa refuzonte që të pranonte sugjerimet e një marrveshjeje direkte me Greqinë, qoftë edhe për një pushtim të përkohshëm prej trupave greke, tha se ai nuk do të

11. Po aty, *Macchio* për *Berchtold*, 19 tetor 1914

12. Po aty, *Berchtold* për *Marcchio*, 22 tetor 1914,

kundërshtonte dërgimin e një regjimenti grek për qëllime politike, duke përmendur premtimin e Venizellosit për t' i tërhequr ato në kohën, kur kjo do të kërkohej. Ai gjithashtu rezervoi të drejtën që të ndërmerre në Vlorë operacione të tilla policore nga ato që do të mund të nevojiteshin për trajtimin e refugjatëve.

Por në të njëjtën kohë ai deklaroi se këto pushtime duhej të ishin të përkohshme dhe nuk duhej të ngatërroheshin me vendimet e Londrës sa i takon Shqipërisë, vendime të cilat do të mbeteshin në forcë.<sup>13</sup>

Vijueshmërisht, më 31 tetor u njoftua se Italia kishte ndërmarrë pushtimin e përkohshëm të ishullit të Sazanit me qëllim që të ruante paasnjësinë e Shqipërisë.<sup>14</sup> Ndaj këtij hapi të ndërmarrë grekët u hakmorën menjëherë duke okupuar Sarandën, Përmetin dhe Gjirokastrën. Venizelloi deklaroi në Parlamentin grek se ky akt ishte një masë politike dhe nuk përbënte ndonjë lloj pushtimi. Qëllimi ishte të rivendosej rendi, të jepeshin mundësitë për kthimin e refugjatëve dhe të lejohej zbatimi i

<sup>13.</sup> *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Berchtold per Macchio, 24 tetor, 1914.*

<sup>14.</sup> *Po, aty, Berchtold per Macchio.*

marrveshjes së Korfuzit aq shpejt sa Fuqitë do të ishin në gjendje të krijonin konditat e nevojshme për zbatimin e asaj marrveshje.<sup>15</sup>

Pushtimi italian i Sazanit u prit nga Fuqitë e Mëdha në përgjithësi në mënyrë evazive, pasi të gjithë ishin aq të zënë me punën e luftës, sa nuk kishin kohë për ta kundërshtuar atë. Qëndrimi i Francës ishte në tërësinë e tij i kënaqshëm, po të kihet parasysh se vetë ajo kishte qëllime pushtuese njësore siç kishin edhe kundërshtarët e saj. Ministri rus i punëve të jashtme, Sazanoff, u shpreh hapur në një intervistë dhënë korespondentit rus të *Corriere della sera*. Ai deklaroi se Rusia nuk kishte kundërshtime për të formuluar. Por motivi i një misioni sanitar i dukej atij të ishte i vetmi pretekst; ai nuk kuptonte se pse Italia e kishte lënë flamurin shqiptar që të valëvitej përkrah flamurit të të tjerëve. Për sytë e tij një shtet shqiptar nuk ekzistonte.<sup>16</sup> Gjermania dhe Austro-Hungaria raportohej ta kishin pranuar veprimin e Venizellosit, me kusht që pushtimi të mos binte në kundërshtim me vendimin e Konferencës së Londrës.

Dy muaj më vonë, duke arsyetuar mbi anarkinë

<sup>15.</sup> *Vellay, Çështja e Adriatikut, f.102-103.*

<sup>16.</sup> *Le Temps, 31 Tetor, 1914*

që mbizotëronte si dhe, sipas një thirrje të qeverisë së Durrësit (ndoshta nga Esat Pasha) për ruajtjen e rendit publik, Italia vazhdoi me pushtimin e Vlorës. Sidoqoftë, në rastin e Vlorës u deklarua se pushtimi do të ishte vetëm i përkohshëm dhe u bë e njohur se Italia nuk kishte qëllim të shkonte më tej në këtë pushtim.<sup>18</sup>

Një vështrim adekuat mbi zhvillimet në Shqipërinë jugore bënte të nevojshëm një vlerësim të qëndrimit, jo vetëm të Italisë, por gjithashtu të Greqisë në drejtim të luftës së madhe. Me shpërthimin e armiqësive, kishte shumë arsye për të supozuar se simpatitë greke shkonin në anën e Antantës; Anglia, Franca dhe Rusia mbronin Greqinë, shtete këto ndaj të cilave ajo kishte detyrime për ekzistencën dhe shtetin e saj të pavarur. Atë e bashkonte me Rusinë e njëjta fe edhe me Francën fakti se gjuha frënge është gjuha e medimeve greke për shkëmbimin e ideve midis njerëzve të ngritur në atë vend, si kudo tjetër në Lindjen e Afërt. Greqia kërkonte nga Anglia mbrojtje si një fuqi detare, flota e së cilës mund të kontrollonte Mesdheun, rruga kryesore e përdorur prej saj. Përveç kësaj në përgjithësi besohej se ajo

18. *Austro-Hungaria, Dokumente Diplomatike, Bechtoldi për Ambrozin. 26 Dhjetor 1914.*

ishite e lidhur me Serbinë nëpërmjet një traktati mbrojtjeje mbështetur në aleancën e viti 1913, teksti i së cilës, nuk u bë i njohur deri dy vitet e fundit; bile as deri në vitin 1925 nuk ishte zbuluar që ky traktat ishte abroguar formalisht që më 1915, kohë kur ishte bërë e qartë se Greqia nuk do t'i hynte luftës në krahun e Antantës.<sup>19</sup>

Eshtë e vërtetë që, në muajt që pasuan luftën, u bënë përpjekje nga ana e shtetarëve vjeneze që të fitonin mbi Greqinë për ta lidhur atë me Fuqinë Qëndrore, por një *përtëritje e miqësisë* dështoi të realizohej për shkak të kundërshtimit ndaj kërkesave të grekëve në kryeqytetet e Bullgarisë dhe Turqisë. Megjithatë me vazhdimin e luftës ishte e qartë se prova e forcës drejtohej tek mbajtja e Greqisë neutrale; kryesorja ndër këto arsye ishte bindja e mbretit Konstandin që militarizmi gjerman kishte të ngjarë që të fitonte.<sup>20</sup>

Sejçili grup i ndërluftuesve ishte në ankth për të siguruar të paktën paansnjësinë e Greqisë dhe po kështu secili prej tyre e ndillte atë me territore në

19. *Publikuar më së pari në Le Temps, 15 Gusht 1916. Për tekstin dhe biseditimet shih Britania e Madhe, Zyra e Luftës, Revista ditore e shtypit të huaj, shtesë speciale greke, f.4-20; New York Times Current History, Tetor 1925, zbulim për abrogimin e Ninchitchit.*

20. *Pribram, politika e jashtme austriake, 1908-'18, f.5051.*

këmbim të kthimit të saj në aleate të vet. Në gusht të vitit 1914, Antantës iu afruan tërë burimet detare dhe ushtarake nga ana e Venizellosit, por ato u refuzuan nga ana e Sër Eduart Grey, i cili u frikësua se mos një pranim i tillë do të kalonte menjëherë Turqinë e ndoshta edhe Bullgarinë në anën e Aleancës Trepalëshe<sup>21</sup>. Kësaj i shtohet edhe rreziku i armiqësisë së Italisë me Antantën, përderisa politika greke synonte ekspansion mbi territore të lakmuara prej ish fuqisë. Është pjesërisht kjo arsyeja, se pse shtetari freng i kërkonte Greqisë që të hynte në luftë pa ndonjë kusht të veçantë, duke e lënë çështjen e kompensimeve territoriale për kohën e zgjidhjes<sup>22</sup>. Për këtë arsye, aleatët menduan të bënin oferta konkrete ndaj Greqisë.

Sidoqoftë, më 22 nëntor 1914 Antanta i bëri një ofertë Greqisë për hyrjen e saj të menjëhershme në ndihmë të Serbisë. Duke vepruar nëpërmjet ambasadorëve të tyre në Athinë, Angli, Francë dhe Rusi, fuqitë anëtare i afruan Greqisë pjesën jugore të Shqipërisë dhe pikërisht Vlorën. Për hyrjen e menjëherëshme, Venizellosi kërkoi një garanci të plotë nga Rumania që kjo e fundit të godiste

21. Churchill, *Kriza Botërore* f.529, Asquith, *Gjenezat e Luftës*, f.223.

22. Abbot, *Greqia dhe Aleatët, 1914-1922* f.231.

Bullgarinë në rast të një sulmi ndaj Greqisë. Kur kjo garanci nuk iu dha, Greqia për rrjedhojë nuk i dha ndihmë Serbisë dhe oferta dështoi.<sup>23</sup> Ministri grek, Repoulis deklaroi se veprimi i parashikuar për t'u kryer nga ana e Greqisë do të ishte i barabartë me vetevrasjen e saj.<sup>24</sup> Sipas deklaratës së Venizellosit një ofertë për shtrirje të territoreve drejt Shqipërisë Jugore, ishte gjithashtu bërë prej Gjermanisë por edhe kjo si dhe ajo tjetra ishte refuzuar.<sup>25</sup>

Nderhyrja greke u bë subjekt i bisedimeve me Antanten në verën e vitit 1915, në fillim të ekspeditës së dardaneleve. Në Mars, qeveria greke, nëpërmjet Zografosit, tani Ministri i saj i punëve të jashtme, njoftoi se ishte gati të asistonte Aleatët në se Bullgaria hynte në luftë, më konditë që integriteti grek të ishte i garantuar dhe po kështu t'i afroreshin kompesime.<sup>26</sup> Gjatë muajve që pasuan qeveria greke ishte më specifike në kërkesat e saj. Kabineti i Gounaris deklaroi gatishmërinë e tij për të hyrë në luftë menjëherë, nëqoftëse Fuqitë e

23. Lolay, *Dokumente sekrete*, f.134-135, Hanson, *Diplomacia sekrete*, f.50.

24. Maccas f.25 note 1.

25. Në fjalën e tij me 26 gusht 1917, shih (Venizellos) *Mbrojtja e politikës kombëtare greke*, f.76.

26. Deville, *Antana, Greqia dhe Bullgaria. Shenime historike* f.142.

Antantës do të ishin gati të pranonin veprime ushtarake kundër Turqisë së bashku me trupat greke. Një ndërhyrje e tillë ishte bërë varësisht nga një garanci formale e dhënë për ruajtjen e integritetit territorial grek, përfshirë “Epirin e Veriut” gjatë të gjithë luftës dhe për një periudhë kohore të caktuar të saj. Propozimi dështoi. A erdhi ky dështim, siç deklaroi ministri francez në Athinë, për shkak të mungesës së sinqeritetit të qeverisë greke kur aleatët i pranuan këto komndita, apo, nga ana tjetër, siç deklaroi ministri grek i punëve të jashtme, prej dështimit të Antantës për të përtërirë bisedimet, kjo është e paqartë. Cilado qoftë arsyeja, Greqia e ruajti paanshmërinë e saj.

Ndërkohë, Greqia e kishte futur një këmbë në “Epirin e Veriut” nëpërmjet pushtimit ushtarak të autorizuar prej Aleateve. Ky pushtim, të cilin Venizellosi e deklaroi në parlament në Dhjetor të 1914-tës, do të mbahej nga një administratë ushtarake për aq kohë sa të ishte e nevojshme dhe për aq kohë sa “rrethanat e tashme ndërkombëtare” do të vazhdonin. Kështu ishte rënë

27. Tekst i plotë i traktatit të fshehtë siç zbulohet në Petrograd, ribotuar nga *Neë Jork-u Evening Post*, f.8

28. Deville, *vepër e cituar*, f.144

29. Tekst i plotë i traktatit të fshehtë, *vepër e cituar*.

30. *Maccas*, f.27 note 3

në ujdi në atë kohë të pushtimit grek dhe italian, që zgjidhja perfundimtare t'i lihej konferencës së ardhshme të paqes. Megjithatë në gusht të vitit 1915 Venizellosi i deklaroi Parlamentit te vet se “vetem gabimet kolosale” mund të ndajnë “Epirin e Veriut” nga Greqia.<sup>31</sup> Padyshim, që të dyja, Greqia dhe Italia, shpresonin që të mbanin teritore të okupuara secila për vete deri në zgjidhjen perfundimtare.<sup>32</sup>

Ndërsa Greqia po i zgjeronte kështu interesat e saj drejt Epirit të Veriut, Austro-Hungaria dhe Italia vazhdonin bisedimet në perpjekje për të arritur një marrëveshje. Në këto bisedime pjesa që luajti Shqipëria tregon rendesinë e saj për këto fuqi.

Në janar, ministri italian i punëve të jashtme, Sonino, mbrojti pikpamjen se interesat e Italisë në Shqipëri konsistonin vetem në pengimin e të tjerëve nga të perfituarit e një pikëmbështetjeje, por nuk kishte për qëllim që të vendosej vetë në trojet shqiptare.<sup>33</sup> Austro-Hungaria argumentoi se

31. *Fjala e Venizellosit e 26 gushtit 1927, shih mbrojtjen që i beri politikës kombëtare greke.*

32. *Il Giornale d'Italia*, 6 tetor 1916; “...ne kemi për qëllim që të sigurojmë për vetvetën dy garanci të fuqishme të cilat nesër do të kenë vlerën e tyre në Konferencën e Paqes...për çështjen e Vlorës”-revista ditore e shtypit të huaj (*Britania e Madhe*), 17 Tetor 1916.

33. *Austro-Hungaria, Dokumenta Diplomatike, Marccio per Berchtoldin*, 6, Janar 1916.

pushtimi italian i Vlorës i dha monarkisë Dyshe të drejtën për kompnese. <sup>34</sup> Por Ambasadori italian në Berlin, Duka i Avarnes, deklaroi se ai veprim nuk ishte një pushtim në kuptimin e plotë të fjalës, por ishte rendi publik që duhej vendosur, si dhe marrja në mbrojtje e integritetit të Shqipërisë, që i kishte detyruar ata të ndërmerrnin një aksion të tillë. Italia, duke qenë neutrale, ishte e vetmja fuqi që mund të përmbushte këtë detyrë në emër të Europës. <sup>35</sup>

Ai shkoi më larg, kur deklaroi se pushtimi ishte i përkohëshëm; Italia do të vazhdonte t'i përmbahej marrëveshjes me Austro-Hungarinë sa i takon Shqipërisë dhe Epirit, dhe te mbronte vendimin e Londres, veçanarisht ato pika që kishin të bënin me paasnjanësinë dhe kufijtë e Shqipërisë. <sup>37</sup>

Me 28 Mars Monarkia Dyshe i bëri Italisë një propozim perfundimtar. Sipas pikave të atij propozimi Italia duhej të angazhohej për të vëzhguar dhe ndihmuar në ruajtjen e paasnjanësisë për sa kohë do të vazhdonte lufta, ndërsa Austro-Hungaria, do t'i lëshonte asaj teritore në jug të

34. Po aty, Berchtold per Marccio, 12 Janar 1915.

35. Po aty, Burian per Marccio, Shkurt 1915.

36. Le Livre vert Italien, Sonnino per Avarnen, 12 Shkurt 1915.

37. Po aty, Avarna per Sonnino, 12 Shkurt 1915.

Tyrolit, përfshirë qytetin e Trentit, si shperblim ndaj lënies së duarve të lira nga ana e të parës në veprimet e saj ne Ballkan si dhe heqjen dorë paraprakisht prej të gjitha kerkesave për kompesim atje, me perjashtim të Shqipërisë, duke iu përmbajtur kështu vendimit te konferencës së Londrës si dhe marrëveshjeve ekzistuese midis Austro-Hungarisë dhe Italisë të cilat do të mbeteshin në fuqi. <sup>38</sup>

Këto propozime të Austro-Hungarisë, u deklaruan prej ministrit italian te punëve të Jashtme si shumë të pamjaftueshme dhe të paqarta. Italia nuk mund t'i jepte Monarkisë Dyshe liri veprimi në Ballkan pa një deklaratë të lëshuar prej saj ku të njoftohej se kjo e fundit ishte komplet e painteresuar per Shqipërinë. Për më tepër, Italia nuk mund të angazhohej më shumë se sa të vëzhgonte një paanësi strikte, përderisa një paanësi mirëdashëse në favor të Austro-Hungarisë, do të çonte në humbjen e dëshirës së mirë të Anglisë, me pasojë mbylljen e ngushticës së Gjibraltarit dhe një sigurim të pakët të lëndëve te para prej të cilave varesh shumë industria italiane. <sup>39</sup>

38. Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Burian për Macchio, 28 mars 1915.

39. Po aty, Macchio për Burian, 31 Mars 1915; Po aty Burian për Macchio, 2 Prill 1915. Livre vert Italien, Sonnino për Avarnon. 31 mars 1915; Po aty, Avarna për Sonion, 2 Prill 1915.

Sonnino, nga ana tjetër, paraqiti pikat në të cilat Italia do të ruante neutralitetin e saj. Midis kushteve të pazevendësueshme për një marrëveshje të qendrueshme midis dy fuqive ishin dhe njohja prej Austro-Hungarisë e sovranitetit të pakufizuar të Italisë mbi Vlorën dhe gjiret e saj përfshirë Sazanin përfshirë dhe aq territore të brendshme sa mund të kerkonte mbrojtja e saj. Ndër to ishte dorëzimi pakushte e të gjitha interesave të Austro-Hungarisë ndaj Shqipërisë, siç ishte vendosur në konferencën e Londrës.<sup>40</sup>

Në përgjigje të këtyre prozimeve, Monarkia Dyshe u deklarua e gatshme që të diskutonte me Italinë interesat e tyre të ndërsjellta në Shqipëri, megjithëse Ballplatzin nuk mund të hiqte dorë nga interesat e veta atje, në një vend kaq të afërt me sferën e interesave vitale të Austro-Hungarisë”

Tashmë çështja shqiptare ishte bërë një çështje evropiane. Vetëm me e një “përqasje të dëshirave të Fuqive të Mëdha mund të modifikohej situata politike në Shqipëri- gjë që ishte eventualisht e pamundur që të bëhej gjatë luftës së tashme”<sup>41</sup>.

40. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Burian për Maccio, 11 prill 1915. Livre vert Italian. Sonnino për Avarnon, 8 prill 1915.*

41. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Burian për Macchion, 16 Prill 1915. Livre vert Italien. Avarna për Sonnino, 16 Prill 1915.*

Austro-Hungaria me të drejtë pa se Adriatiku do të kthehej me të vërtetë në një liqen italian, nëqoftëse Italia do të mbante zotërimin mbi Vlorën.<sup>42</sup>

Kështu më 20 prill, Salanda deklaroi se Shqipëria nuk do të bëhej shkak i një konflikti midis dy aleateve,<sup>43</sup> megjithëse kur u raportua se bisedimet me Antantën ishin në të mbyllur, Austro-Hungaria bëri përpjekjen e saj të fundit të dëshpëruar për të mbajtur Italinë asnjëse. Ajo u tregua e gatshme që në rast të një nevoje ekstreme të deklaronte mosinteresimin e saj ndaj Shqipërisë, me të drejtë që të siguroheshin garancitë ndaj (mos) vendosjes atje të një fuqie të tretë<sup>44</sup>. Kufizimet e mëtejshme të lëshimeve të Austro-Hungarisë sikundër që ishin skicuar nga Vjena ishin që të përfshinin një deklaratë të mosinteresimit të plotë ndaj Shqipërisë, me heqjen dorë ndaj të gjitha rezervave dhe kufizimeve.<sup>45</sup>

Por ndërkohë bisedimet midis Italisë dhe Antantës po përparonin. Filluar në nivelin e ambasadorit italian në Londër, Marquis Imperiali, ato ishin drejtuar prej Sër Eduard Greyt, Mr. Paul Cambonit

42. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Burian për Mecchion, 16 prill 1915.*

43. *Po aty, Machio për Burian, Prill 1915.*

44. *Po aty, Burian për Macchio, 4 maj 1915.*

45. *Po aty, Burian për Macchio, 5 maj 1915.*

dhe Cont Benckendorffit për Aleatet. Përparimi i tyre ishte penguar prej diversitetit të interesave të Fuqive të Mëdha në Londër. Franca, siç ishte raportuar i gjeti kërkesat e Italisë tejet të ekzagjeruara, veçanërisht në bregdetin juglindor të Adriatikut, ndaj u deshën gjashtë javë për të arritur deri tek marrveshja që për rregullimin e detajeve të së ardhmes së ndarjes territoriale të Shqipërisë dhe Dalmacisë.<sup>46</sup> Rezultat i këtyre bisedimeve ishte Traktati i Fshehtë i Londrës i 26 Prillit 1915,<sup>47</sup> në të cilin Italia iu bashkua Aleateve. Në nenin 7 që bënte fjalë për Shqipërinë thuhej:

Duke përfituar Trentinon dhe Istriën prej nenit 4, Dalmacinë dhe ishujt e Adriatikut prej nenit 5, e po ashtu gjirin e Vlorës, Italia, në rastin e një shteti të vogël autonom dhe neutral të formuar në Shqipëri, premton të mos kundërshtojë dëshirën e mundshme të Francës, Britanisë së Madhe dhe Rusisë për të rindarë krahinat veriore dhe jugore të Shqipërisë midis Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë. Bregdeti jugor i Shqipërisë nga kufijtë e territorit italian të

46. Hanson, *Diplomacia sekrete me një aneks plotësues të tekstit të dokumenteve sekrete në Rusi* f.42.

47. *Shih Britania e Madhe, Letra të Parlamentit, LI (1920, 261; Cocks, Traktatet e fshëhta dhe marrveshjet. f.27-28; Temperley, vepër e cituar, V, 384-93.*

Vlorës deri tek Kepi i Stillos do të ishin neutrale.

Italisë do t'i njihej e drejta e drejtimit të marrdhënieve të jashtme të Shqipërisë; për çdo rast, Italia do të detyrohej të siguronte për Shqipërinë një territor mjaft ekstensiv për të mundësuar që kufijtë e saj tu bashkoheshin atyre të Greqisë dhe Serbisë në perëndim të Liqenit të Ohrit.

Mbështetur në këtë pikë të paktit, Fuqitë e Antantës u morën vesh që t'i jepnin Italisë si një pjesë të çmimit për hyrjen e saj në luftë, futjen e një këmbë në Ballkan aq shumë e lakmuar prej saj. Bisedimet që çuan në këtë pakt të fshëhtë e të poshtër nuk u publikuan dhe vendimet e tij mbetën të panjohura derisa bolshevikët zbuluan diplomacinë e Antantës në sytë e botës. Pikat e tij bënë të mundur që Aleatet të shpërblenin miqtë e tyre, Serbinë dhe Greqinë (në se kjo e fundit do të futej në luftë). Ndërkohë, meqë Italia ndjehej e kënaqur me pazarllëqet e bëra, pasi ajo do të gëzonte lëshime të mëdha territoriale, të cilat, është e vërtetë, se qeveritë e Antantës nuk i kishin në fuqinë e tyre që t'i jepnin, më 28 maj ajo i hyri luftës në anën e Aleateve.

Zhvillimi tjetër i rëndësishëm përfshiu vendin tjetër mesdhetar, Greqinë. Pushtimi grek i "Epirit të Veriut" i autorizuar prej Aleateve më 1914, pikërisht

në kohën e vendosjes së Italisë në Vlorë, zgjidhja e të cilit i ishte lënë shprehimisht Konferencës së Paqes, e që s'bën që të harrohet, u shfrytëzua prej pasuesve të Venizellosit. Duke e gjykuar atë kohë si të përshtatshme për një fait accompli ata nxitën shpresa tek popullsia e Vorio Epirit se ai do të mund të merrte pjesë në zgjedhjet e reja kombëtare.<sup>48</sup> Në dhjetor 1915, deputetë prej "Epirit të Veriut" u derguan në Parlamentin Grek për të kërkuar njohjen nderkombëtare të bashkimit të asaj provincë me Greqinë dhe në hapjen e parlamentit të ri më 11 janar 1916, qeveria iu dha atyre vendet. Në Shkurt ajo procedoi me zëvendësimin e autoriteteve ushtarake të pushtimit me civile dhe në muajin pasardhës shtypi shqiptar njoftoi firmosjen e një dekreti mbretëror që ribashkonte plotësisht "Epirin e Veriut" me mbretërinë greke<sup>49</sup>. Kryetari i këshillit të ministrave, Skouloudis u shpreh hapur në parlamentit se "Epiri i Veriut" me kufijtë e tij të tashëm përbënte një pjesë integrale të mbretërisë Greke<sup>50</sup>. Ky veprim ishte karakterizuar prej Kiryxit, organi zyrtar i shtypit të Venezillosit, si akt që

48. Venezillos, *Historia e Greqisë, 1912-1917, Diskurse në parlament, Gusht 1917*, f.17.

49. Laloy, *vepër e cituar*, f.141; *Le Temps*, 21,22 Mars 1916.

50. Laloy, *vepër e cituar*.

përbënte një sukses të klasit të parë për Greqinë.<sup>51</sup>

Megjithkëtë përfshirja e Epirit të Veriut në Greqi, nuk u pranua prej Fuqive të Antantës, siç shpresohet në Greqi. Kështu të zhytura në luftë këto Fuqi kërkuar një shpjegim. Qeveria greke iu përgjigj kundërshtimit të tyre se administrata civile konsiderohej si e domosdoshme për të zëvendësuar atë ushtarake<sup>52</sup>. Një note e dytë e Aleatëve nënvizonte papajtueshmërinë e fjalëve të Skouloudisit në parlament, me faktin se rajoni në fjalë ishte përfshirë në principatën e Shqipërisë me vendim të Fuqive me 1913.<sup>53</sup> Në përgjigjen që dha ministri helenik deklaroi se shkaku i pjesmarrjes së deputetëve epiriotë ishte domosdoshmëria e garantimit të zërit të epiriotëve në legjislaturë dhe votimi për taksat prej nga dilte mbajtja e administratës<sup>54</sup>. Sidoqoftë, si rezultat i protestave të Aleatëve, qeveria greke u detyrua të mos lejonte edhe më tej pjesmarjen e deputetëve të Epirit të Veriut.<sup>55</sup>

Rënia në dorën e Fuqive Qëndrore e Fort Roupelit në maj, shënoi fillimin e një periudhe thujse të

51. Maccas, *Ainsi për Venezillosin* f.28 nota 1.

52. Laoly, *vepër e cituar*, *Christian Science Monitor*, 3 prill 1916.

53. *Le Temps*, 2 prill 1916.

54. Laoly, *vepër e cituar*.

55. Venezillos, *Historia e Greqisë*, f.17; *Le Temps*, 6 maj 1915.

hapur armiqësore midis qeverisë greke dhe Aleateve. Pasojë e humbjes së besimit ndaj Greqisë ishte ekspansioni i Italisë drejt Epirit të Veriut, i shoqëruar me një tërheqje të detyruar të Greqisë nga zona e lakmuar prej saj. Vetëm pak kohë më parë Greqia dukej sikur ishte e sukseshme në plotësimin e dëshirave të saj për ta shtirë atë përfundimisht në dorë<sup>56</sup>. Ministri i Greqisë në Romë raportoi se italianët ishin gati të mendonin se Greqia do tu lëshonte pe bullgarëve në Epir, sikundër kishte bërë edhe në Maqedoni dhe se kjo ishte e pavlefshme për të vendosur ndonjë besim në “garancitë e saj iluzive”<sup>57</sup>. Në këtë mënyrë, në fillim të Qershorit, italianët e pushtuan Janinën,<sup>58</sup> një qytet i zotëruar nga grekët, që nuk përfshihej në “Epirin e Veriut”, një veprim ky i kundërt me deklaratën e shkruar të ministrit italian në Athinë, e cila përjashtonte përparimin e ushtrisë italiane të Vlorës tej kufijve veriore greke.<sup>59</sup>

Si rezultat i dorëzimit të Fort Roupel-it, Britania

56. *Fjala e Venezillosit e 26 Gushtit 1917. Mbrojtja e politikës kombëtare greke*. fl.37.

57. *Traktati i aleancës greko-sërbe; Pushtimi gjermano-bullgar i Maqedonisë. Coromilas për Skouloudis, 13-17 maj 1916*

58. *La Matin, 12 qershor 1917.*

59. *Le Temps, 22 mars 1916.*

e Madhe, Franca dhe Rusia si mbrojtëse të Greqisë, i bënte një seri kërkesash qeverisë greke, kryesorja prej të cilave lidhej me çmobilizimin e ushtrisë. Kjo kërkesë u përsërit në një note të 21 qershorit 1916, në të cilën ishte marrë përsipër që çmobilizimi të kërkohej jo vetëm ndaj Mbretërisë Helenike, por gjithashtu ndaj “Epirit të Veriut”<sup>60</sup> Pak ditë më vonë, mbështetur në këtë kërkesë kryeministri i ri Zaimis, e informoi ministrin italian në Athinë se ushtria, përfshirë edhe njësi të Epirit të Veriut ishin vënë në një gjëndje paqeje.<sup>61</sup>

Veprimi i nxituar i qeverisë së Skouloudis-it, në përpjekjet e saj për të aneksuar Epirin e Veriut me 1916, solli në vend të pritjes për përfundimin e luftës ku do të konfirmoheshin zotërimet e saj, si dhe në vend të mosbesimit të qeverisë greke ndaj Aleateve pas dorëzimit të Fort Roupel-it, humbjen e “Epirit të Veriut” dhe pushtimi i asaj krahine prej fuqisë rivale, Italisë.

Shpresat greke ishin shkatërruar. Pushtimi italian u denoncua prej një gazete helenike (Nea Ellas) si një “thikë në zemrën e Greqisë”, por në të njëjtën kohë ishte bërë e njohur se përgjegjësia e vërtetë

60. *Po aty.*

61. *Po aty.*

për humbjen qëndronte tek vetë Greqia. *Estia* gjithashtu vajtonte rreziqet që kërcënonin Epirin e Veriut, duke vënë ballë për ballë sigurinë e provincës nën regjimin e Venizellosit me atë të pozitës së saj të mëpastajme <sup>62</sup>. Gjithashtu ministri italian në Athinë siguroi Politisin, se i vetmi qëllim i pushtimit italian ishte të garantonte sigurinë e ushtrisë italiane në Vlorë, duke penguar kështu edhe kontrabandën dhe spiunazhin.<sup>63</sup> Aleatët prematuan në një note të shpërndarë nga fundi i dhjetorit, se nuk do të lejonin forcat e armatosura të qeverisë së mbrojtjes kombëtare (venizelloiste) që të përfitonin nga tërheqja e trupave mbretërore nga Thesalia dhe Epiri prej kalimit të zonës neurale të formuar në marrëveshje me qeverinë greke <sup>64</sup>. Prandaj rritja e veprimtarisë së italianëve tre muaj më vonë në përparimin e tyre drejt Janinës çuditi qeverinë greke. Përparimi i vazhdueshëm i trupave franceze në jug të zonës neutrale në Thesali dhe italianëve tek lumi Kalamas tërhoqi vëmëndjen e qeverisë helenike, por ndërsa përparimi francez nuk përbënte ndonjë shqetësim të madh, meqë ai nuk nënkuptonte

62. *Kronika e përditshme e shtypit të huaj. (Britania e Madhe) 11 Shtator 1916.*

63. *Christian Science Monitor*, 9 Tetor 1916.

64. *The Times (Londër) 2 janar 1917.*

pushtimin e krahinës, shtypja italiane mbi autoritetet dhe mësuesit grekë nga njëra anë dhe ankesat që flamuri italian po ngrihej në Epir në anën tjetër, çoi deri tek një protestë ndaj ministrit italian në Athinë, e cila mëshironte të tëra kërkësat për tërheqjen e italianëve prej pjesëve të Epirit të pushtuar rishtaz.<sup>65</sup>

Kur në fillim të Qershorit, italianët hynë në Janinë, qeveria Helenike iu dha urdhër autoriteteve civile dhe ushtarake të qytetit që të shprehnin protestën e tyre.<sup>66</sup>

Kjo çështje nuk u zgjidh derisa Aleatët e rrëzuan nga fronti Konstandinin më 29 Qershor 1917 dhe Venizellosi u rikthye në fuqi. Ndërkohë ndodhi një zhvillim tjetër i rëndësishëm për Epirin e Veriut me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë prej gjeneralit Ferraro në Gjirokastër më 3 Qershor 1917.<sup>67</sup> E gjithë Shqipëria u shpall e bashkuar dhe e pavarur “nën kujdësin dhe mbrojtjen e Italisë”.

Kjo shpallje nxiti një furtunë protestash si brenda dhe jashtë Italisë. Ajo nxori në sipërfaqe divergjencat midis antarëve të ministrisë kombëtare italiane dhe

65. *Shtesë e shtypit aleat (Britania e Madhe) 27 Qershor.*

65. *Po aty, 28 mars, 1917; Kronika e përditshme e shtypit të huaj. 5 prill 1917. (Athenai 24, 25, 26 Mars).*

66. *Le Temps, 7,13 Qershor 1917.*

67. *Për tekst: shih Çekrezi, vepër e cituar f.161; Christian Science Monitor, 11 qershor 1917; Le Matin, 6 Qershor 1917.*

i bëri gazetatat që të përcaktonin qëndrimet e tyre ndaj luftës nga njëra anë dhe metodave diplomatike nga ana tjetër. Veprimi i Soninos ishte një habi e madhe për gjithkënd, bile edhe për kolegët e tij. Si një protestë ndaj metodave të tij imponuese aq sa pjesërisht edhe për arsyetimin anti-imperialist, katër ministra, përfshirë këtu edhe atë të së majtës Demokratike Intervesioniste paraqitën menjëherë dorëheqjen e tyre, për të cilën, më vonë, ata u bindën që ta anulonin<sup>68</sup>. Gazetat italiane ndryshonin në reagimet e tyre. Të moderuarat kërkonin kufizimin dhe përcaktimin e kuptimit të kësaj shpallje, për ta bërë atë të pranueshme për Aleatët, gjë që do të lehtësonte justifikimin përpara opinionit rus e amerikan me synime nacionaliste. Nacionalistët ishin plotësisht të ekzaltuar, ndërsa Idea Nazionale deklaronte se Italia e kishte kërkuar këtë për dyzet vjet rresht, por ishte penguar prej Austro-Hungarisë të vendosej në Shqipërinë Jugore, çka do të bënte që sllavët dhe grekët, kërkesat e të cilëve tashmë e kishin humbur vlerën e tyre, të mbaheshin larg prej këtyre trojeve. Internacionalistët radikale shfaqën armiqësinë e tyre ndaj diplomacisë sekrete.<sup>69</sup>

68. Shtesë e shtypit aleat (Britania e Madhe) 27 Qershor 1917.

69. *Daily Review of the Foreign Press*, 12 Qershor 1917.

Pikpamja zyrtare italiane ishte se derisa lufta i kishte zhvleftësuar angazhimet e saj ndaj Austro-Hungarisë ajo ishte e lirë të rimerre përsëri kursin e saj në politikën tradicionale të simpatisë ndaj kombit shqiptar.<sup>70</sup> Qëndrimi i shtypit francez ishte ai i një shtypi të dyshimtë, pasi ai nuk pajtohej me proklamaten italiane dhe as me erën e re të diplomacisë që kishte hapur revolucionin rus dhe ndërhyrja amerikane, në pikpamjen e nevojës për t'i përshtatur marrdhëniet e reja me marrdhëniet e kaluara dhe zgjidhjet e së ardhmes. Ishte kjo e fundit, sipas *Le Temps* që "i jep këtij fakti rëndësinë e vërtetë"<sup>71</sup> Në Rusi proklamata shkaktoi një sensacion. Terestchenkos, ministër i jashtëm në qeverinë e Kerenskit, pasi u këshillua me shefat e misionëve aleate, deklaroi në Kongresin e Sovjetëve se gjendja kërkonte domodoshmërisht vlerësime ushtarake; ai shtoi se qeveria ruse mendonte që fati përfundimtar dhe organizimi Shqipërisë duhej të lihej për t'u rregulluar plotësisht në mbarim të luftës duke zbatuar principet që popujt kanë të drejtë të rregullojnë vetë punët e tyre<sup>72</sup>. As Britania e Madhe,

70. *Le Temps*, 7 Qershor 1917.

71. *Po aty, Allied press Supplement*, 21 Qershor 1917, f.151.

72. *Përgjigjet e Balfourit në Dhomën e Ulët*, 21, 27 Qershor 1917. *Debate Parlamentare, Dhoma e Ulët, XCIV, 1944I, 356-57*

por as Franca nuk ishin konsultuar më parë dhe asnjëra nuk dha ndonjë njohje zyrtare ndaj protektoratit italian.<sup>73</sup> Meqënëse deri në atë kohë, Traktati i Londrës i 1915-ës vazhdonte të mbetej sekret, papajtueshmëria e të dy programeve nuk u shpallën publikisht. Ndërkohë, me abdikimin e Konstandinit dhe kthimin në fuqi të Venizellosit, u bë krejtësisht e qartë se përderisa një siguri ushtarake nuk ishte edhe më tej e nevojshme, pushtimi italian duhej të merrte fund.<sup>74</sup> Bisedimet greko-italiane u ndërmorën menjëherë në mes të Venizellosit dhe të ministrit italian në Athinë, Bosdar, duke vendosur që në konferencën e korrikut në Paris aleatët të rregullonin tërheqjen e Italisë tërësisht nga territoret e okupuara, përveç zonës trekëndëshe të Greqisë e që formohej në kalimin e rrugës nga Saranda në Korçë dhe që Italia dhe Greqia duhej të pajtoheshin për rivendosjen e administratës civile nën autoritetin e një komisioneri të zgjedhur prej qeverisë greke<sup>76</sup>. Fill pas kësaj ky komisioner filloi nga detyra në këtë post. Evakuimi italian nga Janina dhe Epiri u vlerësua drejtpërsëdrejti si një fitore e Venizellosit.<sup>77</sup>

73. *Le Journal des Hellenes*, 1 Qershor 1917.

74. *Le Temps*, 1 Qershor, 1917.

76. *Po aty*, qershor 1917.

77. *Po aty*, 6 gusht 1917.

Italianët e trajtuan të ashtuquajturën “territor të sigurisë” se Vlorës dhe Himarës si një koloni të vërtetë italiane. Me t`u instaluar në Vlorë, Italia vendosi administratën financiare, juridiksinin kriminal, kontrollin e doganave dhe, me shtrirjen e kontrollit të saj në çdo fushë, kërkoi viza në pashaportat e të gjithë atyre personave, që dëshironin të hynin në Vlorë.<sup>78</sup> Punët publike u riorganizuan dhe u vunë në varësi të prefekteve; rrugët e hapura prej autoriteteve ushtarake u ndërtuan me qëllim përdorimi të përhershëm dhe përbënin një përfitim të madh për shqiptarët. Në kalanë e vjetër të Gjirokastrës u organizua një milici lokale, e instruktuar mirë dhe e armatosur, e drejtuar prej djelmoshash shqiptarë, nxënës të shkollave ushtarake italiane.<sup>79</sup>

Ndërkohë në pjesën juglindore të Shqipërisë, në ish kazanë e Korçës, kishin ndodhur ngjarje të një rëndësie të veçantë. Ky rajon që lidhej me Maqedoninë dhe i okupuar prej grekëve që prej 1914-ës, formonte pjesën e një zone neutrale në mes të Shqipërisë dhe Greqisë, të vendosur prej

78. *Austro-Hungaria, Dokumente Diplomatike, Von Mayrhauser për Burian*, 20 janar, 1 shkurt 1915; *Burian për Macchio*, 4 shkurt 1915.

79. *Chekrezi, vepër e cituar f.183-84; Bourcart, vepër e cituar f. 145.*

aleatëve gjatë luftës për të izoluar Greqinë dhe për të mbrojtur frontin e tyre. Më 1916 kjo u bë qëndër e intrigave italiane, venizoliste, “esadiste”, serbe, mbretërore-po aq sa edhe fushë e njohur e spiunazhit asutro-bullgar nëpërmjet të cilit mbahej komunikimi konstant me mbretin Konstandin.<sup>80</sup>

Në fillim të Dhjetorit 1916, gjenerali francez në Maqedoni, Sarrail dërgoi trupat nën kolonelin Descoins për të pushtuar Korçën, me qëllim qetësimin e vendit, pengimin e spiunazhit dhe kontrabandës dhe, mbi të gjitha, sigurimin dhe mbrojtjen e ushtrisë. Qeveria e përkohëshme e Venizellosit në Selanik e shqetësuar ndaj bashkimit të këtij rajoni me Maqedoninë, tashmë pak a shumë e mbledhur nën mbrojtjen e saj, dërgoi në Korçë prefektin M. Argyropulis.<sup>81</sup> Por Sarrail i kërkoi Venizellosit t’i thërriste rishtaz përfaqësuesit e tij, se prezenca e të tyre ndihmonte çrregullimin, duke shtuar edhe një luftë midis venizellozistëve dhe konstandinistëve ndaj intrigave italiane kundër pushtimit grek.<sup>82</sup> Rojalistët grekë në fuqi ishin progjerman të fuqishëm, ndërsa nacioanlistët vendas

80. Sarrail, *Mon commandement en Orient (1916-1918)* f.220.

81. Vaucher, *Illustrime*, 7 Prill 1917.

82. Borcart, *vepër e cituar* f.155.

shqiptarë, antigrekë të vendosur, në pjesën më të madhe të tyre proaustriake dhe antifranceze. Ky orientim i politikës së tyre vinte si rezultat i prohelenizmit të Francës në Konferencën e Londrës dhe të mbështetjes që kishin gëzuar prej Austro-Hungarisë. Me dorëzimin e kodrave në zotërim të bandave rivale shqiptare, në kohën kur trupat franceze arritën në Korçë, situata për Francën dukej kritike.

Udhëheqësi i kristianëve shqiptarë në Korçë, Themistokli Gërmenji, një nacionalist i bindur, deklaroi se francezët do të gëzonin qetësi në terren, nëqoftëse ata do të shpallnin pavarësinë e Shqipërisë gjatë kohës së përpjekjeve për mbrojtje ushtarake.<sup>83</sup> Sipas kësaj, më 10 dhjetor 1916, delegatët shqiptarë përpiluan një protokoll të nënshkruar prej tyre dhe kolonelit Descoins, i cili e deklaronte Shqipërinë të pavarur nën mbrojtjen ushtarake franceze. Autoriteti qeveritar, si ai legjislativ ashtu edhe ai ekzekutiv përbëhej prej një komisioni prej katërmëdhjetë antarësh, prej të cilëve gjysma ishin të krishterë dhe gjysma myslimanë. Autoritet ushtarake franceze ishin të mendjes se duhet të miratoheshin emërimet e drejtorëve të shërbimit publik. U krijua gjithashtu

83. *Po aty*.

një milici dhe xhandarmëri e cila, në rast të nevojave ushtarake, do të vihej nën komandën franceze. Gjuha shqipe u deklarua se do të ishte gjuha zyrtare dhe flamuri i republikës do të ishte ai tradicional i Skëndërbeut i kombinuar me flamurin tringjyrësh francez.

Sarrailit, kur iu kërkua një spjegim prej Quai D'orsey ndaj këtyre ngjarjeve, nën presionin e Romës, u përgjigj se ai kishte bërë çfarë ishte e nevojshme të bëhej për ushtrinë dhe duke ndjekur politikën e tij të mos ndërhyrjes në politikën e brendshme në Ballkan, kishte lejuar popullsinë të bënte çfarë asaj i pëlqente.<sup>85</sup> Veprimi i Sarrailit për të mos i shërbyer politikës konstandiniste përbënte një shqetësim të madh për politikën imperialiste italiane<sup>86</sup>. Pushtimi francez ishte padyshim një rast i mirë për shtrirjen e italianëve në Epirin e Veriut, një tjetër rrjedhojë kjo e politikës progjermane e qeverisë rojaliste greke.

Përpyekjet e administratës franceze të Korçës qenë të suksesshme për t' u mësuar shqiptarëve të këtij rajoni disa prej leksioneve se si mund të vetë-qeverisej

<sup>85</sup>. Për tekstin e protokollit, shih Kolovani, *Çështja e Korçës* f.8-10. Shih gjithashtu nga gazeta shqiptare *Adriatik* në Aubry, *Shqipëria dhe Franca* f.45-46.

<sup>86</sup>. Për telegramet shih Sarrail, *vepër e cituar* f.221-22.

nën tutelën e atyre që kishin më shumë përvojë e që kishin prirje pozitive. Administrata qëndrore e vendosur në Korçë, u zvogëlua drejt një minimumi; tre territoret Korçë, Pogradec dhe zona neutrale greko-shqiptare brenda territorit grek) u vunë nën urdhër të një administratori rezident, secila duke patur nja shkallë të gjërë autonomie administrative, duke iu dhënë mundësinë që të drejtonin shërbimet dhe buxhetin e tyre. Të gjitha porositë nga Parisi, këshillonin paanësi strikte në marrdhëniet e francezeve me shqiptarët dhe grekët, ndërsa ministri francez, për të shmangur kundërshtimin grek, refuzoi dhënien e lejes për të hapur një lice francez në Korçë. Por me mbylljen e shkollave greke nja dyqind vendas u futën në shkollat ku shqipja dhe frengjishtja ishin gjuhët e mësimi. Qëndrimi i paanshëm në dhënien e drejtësisë nga ana e gjykatave u mirëprit si dhe u bënë punë të shkëlqyera në kontrollimin e ushqimit të popullatës, për realizimin e të cilave ishte marrë një konsensus.<sup>87</sup>

Një fakt shumë kuptimplotë, që nuk mund të mos vihej re, ishte se të krishterët dhe myslimanët punonin krah për krah.

<sup>87</sup>. Ancel, *Ushtria orientale* f.142, Bourcart, *vepër e cituar*; f.156. Italia dhe Bota f.300.

Mbasi Quai d'Orsay nuk kishte ndonjë dëshirë ta zhvillonte lëvizjen kombëtare shqiptare si tepër nën kontrollin francez, <sup>88</sup> më 16 shkurt 1918, kur Sarraill nuk ishte edhe më tej aty për të mbrojtur punën e bërë, trashëgimtari i tij gjenerali Salle, e abrogoi protokollin e viti 1916.<sup>89</sup> Korça vazhdoi të gëzonte në esencë të njëjtën qeveri, megjithëse ndryshimet ishin vetëm nominale. Flamuri shqiptar vazhdonte të valëvitej në Korçë, por autoriteti ushtarak vendoste tani mbi masat administrative që duheshin marrë <sup>90</sup>. Muaj më vonë, shkollat greke u rihapën si rezultat i influencës greke. Fakti që administrata franceze e qytetit ishte detyruar me urdhër nga Parisi të zbatonte masa në "kontradiktë flagrante me dëshirat e popullsisë", spjegohet me rritjen e influencës së Venizellosit, i cili duhej shpërblyer për lëvizjen e bërë prej tij duke iu bashkuar Antantës.<sup>91</sup>

Kur armëpushimi i mbylli armiqësitë, francezët italianët dhe grekët u lejuan që të mbeteshin në zotërim të përkohshme të krahinave të pushtuara prej tyre; francezët në Korçë, italianët në Vlorë dhe në një pjesë të konsiderueshme tokësore, dhe grekët në pjesën tjetër të Epiri të Veriut. Meqë në këtë rast zgjidhja përfundimtare u shty konsiderueshëm, pushtimi vazhdoi për disa kohë.

88. Bourcart, *Shqipëria dhe shqiptarët*, f.159-65; Kolovani, *vepër e cituar* f.10-11, 31-39.

89. Bourcart, *vepër e cituar* f.159.

90. Për tekst, shih Kolovani, *vepër e cituar* f.72-73.

91. Po aty, f.16.

## V. KËRKESAT E GREKEVE DHE SHQIPTAREVE NE KONFERENCEN E PAQES.

Me zhvillimin e mëtejshëm të luftës, qëllimet e palëve ndërluftuese u bënë gjithnjë e më të qarta. Në çdo deklaram rreth luftës, principet e vetpërcaktimit ishin të pranishme. Në prill të vitit 1917, qeveria e përkohëshme e Rusisë deklaroi se qëllimi i i saj ishte "të ndërtonte një paqe të qëndrueshme mbi bazën e të drejtave të kombeve për të vendosur për të ardhmen e tyre". <sup>1</sup> Deklarata e Lloyd Xhorxhit e janarit 1918, duke vlerësuar kushtet që duheshin të përmbusheshin përpara se të shpresohet për një paqe të përhershme, tha se "një zgjidhje territoriale duhet të jetë e bazuar ose në vet-vendosjen, ose në marrveshjen midis qeverive"<sup>2</sup>. Një muaj më vonë më 11 shkurt, në një fjalim të famshëm, presidenti Uillson shpalli se "vetvendosja" nuk është një frazë e thjeshtë. Është

1. Scott, *Deklarat zyrtare për qëllimet e luftës dhe propozimet për paqe*. f.95 (tekst për *The New York Times*, 11 prill 1917). Për përmbledhjen e qëllimeve të luftës shih gjithashtu Blagoyevitch, *Principet e nacionalizmit* f.158-204. Henderson, f.83. *Labour Year Book*, 1919 f.25-41.

2. Lloyd George, *British War Aims* f.15.

një imperativ i veprimit të burrave të shtetit, të cilët, që nga kjo kohë duhet të mos marrin parasyshtë rreziqet që atyre u kanosen personalisht<sup>3</sup>. Këto janë veçse shembuj qëndrimi mikpritës që i referohen vetëvendosjes, të bëra në dy vjetët e luftës. Një shprehje stereotipe në buzët secilit, gjen një përgjigje zemre nga të gjitha popujt e vegjël ose të shtypur të të gjithë rruzullit. Fjalët e Lloyd Xhorxhit, të cituara më sipër, patën një jehonë të gjërë në zemrat e shumëkujt. Gazeta greke Patris shprehte besim në këto fjalë duke deklaruar se, "Kombi grek nuk ka dëshiruar kurrë më shumë se sa këtë... Ne nuk kërkojmë as aneksim e as ekspansion imperialist. Por ne nuk do të braktisim ato që na takojnë prej traditës historike dhe konstitucionit etnologjik"<sup>4</sup>.

Qeveria italiane deklaroi, në përgjigjen e saj ndaj notës ruse të Majit se Italia kishte hyrë në luftë, për triumfin e principeve të shenjta të lirisë së popujve të shtypur... Të gjithë shpirtrat e pushtuar ose të dominuar ishin ekskluduar nga politika e saj.<sup>5</sup>

Shumë deklarata u bënë, nisur veçanërisht nga kërkesa që Konferenca e Paqes duhej të kishte

3. Wilson, "Kater principe të paqes" Fjala në Kongres 11 shkurt 1918, rishtypur në vende të ndryshme nga origjinali i kongresit, LVI, 1937.

4. Shtesë e shtypit aleat, 13 shkurt 1918.

5. *Le matin*, 20 Qershor 1917

vepruar në lidhje me çështjen shqiptare. Midis tyre shquhej ajo e vitit 1914, e cila autorizonte pushtimin grek dhe italian; pastaj vinte ajo e bërë më 1917, mbas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë nga italianët, kur Sonino deklaroi se Fuqive në takimin që do të kishin për të diskutuar rreth traktatit të paqes i mbetej si detyrë e përgjithshme, përcaktimi i përpiktë i kufijve të shtetit Shqiptar ndaj shteteve fqinj të saj<sup>6</sup>. Balfour, duke u përgjigjur në dhomën e komunave, më 18 shkurt 1918 tha:

Rregullimet e bëra më 1913, ndaj të cilave Shqipëria nuk ishte palë, kanë pushuar së qënuri më forcë, pasi të gjitha Fuqitë nënshkruese tani janë të përfshira në luftë. Sa i takon të ardhmes... qeveria e madhërisë së tij do të ishte e kënaqur të shikonte principet e nacionalitetit të zbatuara sa më shumë të jetë e mundur, ashtu siç do të ishte e kënaqur të shihte çështjet e tjera të vështira të zgjidhura, të cilat i mbetën Konferencës së Paqes.<sup>7</sup>

Mbështetur në dy themele, vetvendosjea abstrakte dhe premtimie për një zgjidhje përfundimtare të çështjes shqiptare në Konferencën e Paqe, të dyja

6. *Kronikë ditore e shtypit të huaj*, 23 qershor 1917

7. *Debate Parlamentare, Dhoma e Ulët (1918) CIII, 454. Shih gjithashtu deklaratën e Balfourit të 5 Dhjetorit 1917 në Dhomën e Komunave: Po aty (1917) C,400*

palët, si grekët edhe shqiptarët ushqyen shpresa të mëdha me të cilat u nisën për në Paris.

Programi i Uillsonit, ku figuronte vetvendosja, ishte mishëruar në marrëveshjet e armëpushimit, marrëveshje e cila nuk iu lejonte Aleatëve të paraqitnin pika të cilat binin ndesh me këto principe.<sup>8</sup>

Siç del edhe nga deklarata e bërë më vonë prej tij, Presidenti Uillson këto kushte i vlerësonte si të detyrueshme për aleatët, ndaj thoshte se ai "nuk ndjehej i lirë në se sugjeronte një bazë për paqe me Gjermaninë dhe një tjetër me Austrinë"<sup>9</sup> Kur kushtet e armëpushimit të Gjermanisë ishin në shqyrtim u paraqitën dy rezervime, njëra prej britanikëve mbi lirimin e deteve dhe një tjetër prej italianëve, të cilët e kundërshtuan dy herë pikën e nëntë e cila siguronte një "rishikim i kufijve të Italisë duhej të përmbushej bashkë me linajt e njohura qartë të kufijve nacionale". Kur e mori vesh se kjo pikë nuk ishte në diskutim, Orlando tha se në momentin më të përshtatshëm ai

8. Shih veçanërisht notën që qeveria e Austro-Hungarisë i dërgon sekretarit lansing, 29 tetor 1918. Buletini zyrtar i SHBA-ve 31 tetor 1918. Rishitypur me dokumente që kanë të bëjnë me të, në *Intercional Conciliation*, nr.133 (dhjetor 1918)

9. "Memorandum në lidhje me çështjet e kërkesave italiane në Adriatik", 14 Prill 1919, dokumenti 35, në Baker, Woodrow Wilson and World settlement, III, 274.

do të ripërtërinte kundërshtimin që ai tashmë e kishte ndërmarrë; por kundërshtimi italian, ndryshe nga ai britanik, nuk u bë publik për shumë kohë deri sa erdhi një moment kur ishte tepër vonë (1 Maj 1919)<sup>10</sup> për të patur ndonjë efekt në diskutimet rreth tij.

Një zgjidhje e përshtatshme e bazuar në principet e nacioanlizmit dhe të vetvendosjes do të ishte mjaft e vështirë për t'u arritur. Përveç kësaj situata në Konferencën e Paqes nuk ishte e thjeshtë: Traktatet e fshehta në kontraktitë flagrante me qëllimet e pranuar dhe të shpallura hapur të Aleatëve i komplikonin të tëra përpjekjet për një zgjidhje. Kushtet e Traktatit të Fshehtë të Londrës të cilat e futën Italinë në luftë ishin qartazi kundër principeve të vetvendosjes. Në të vërtetë, beteja e Konferencës së Paqes sillej rreth çështjes se sa peshë duhej t'i jepej traktateve sekrete. Duke iu referuar Traktatit të Londrës një autoritet ka thënë:

Ai ishte pengesa kryesore në Konferencën e Paqes. Për shkak të debateve të cilat vërtiteshin rreth tij, kësaj çështjeje iu kushtua më shumë rëndësi në diskutimet e Këshillit të të të Katërtve, këshillave të tjerë dhe komisioneve se sa ndonjë çështje tjetër të

10. *The Times*, (Londër), 2 maj 1919.

vetme të diskutuar aty.<sup>11</sup>

Publikimi i traktateve sekrete prej bolshevikëve në Nëntor të 1917-tës, megjithëse në krahasim me rëndësinë që kishin, iu kushtua pak vëmendje prej publikut të përgjithshëm, i vinte në pozitë të vështirë aleatët. Lloyd Xhorxh në fjalimet e tij në Konferencën e Tred Unioneve të 5 janarit 1918, në një përpjekje për të pajtuar kriticizmin radikal të luftës tha:

“Shumë është thënë rreth parapërgatitjeve të bëra me të cilat ne kemi hyrë së bashku me Aleatët tanë në këtë çështje, (coptimin e Turqisë) dhe çështje të tjera. Unë mund të them vetëm se rrethanat e reja siç janë kolapsi dhe bisedimet e veçuara ruse, kanë ndryshuar kushtet nën të cilat këto parapërgatitje ishin bërë; ne jëmi dhe gjithmonë kemi qënë plotësisht gati për të diskutuar me aleatët tanë.<sup>12</sup>”

Kur u hap Konferenca e Paqes, ky ishte ndoshta prononcimi më i qartë që ishte bërë e që meritonte t'i bashkangjitej traktateve të fshehta.

Dy muaj pas armëpushimit, në Konferencën e Paqes të mbledhur në Paris, në sesionin e parë plenar të saj të mbajtur më 18 janar 1918, Greqia ishte

11. Baker, *vepër e cituar I*, 52, 1919.

12. Lloyd George, *vepër e cituar f.11-12*.

njëra prej më të favorizuarave prej kombeve ndërluftuese, edhe pse kishte luajtur një rol krejt të vogël në këtë luftë. Asaj i ishin dhënë dy delegate, por meqënëse delegatet votonin si një njësi, kjo nuk përbënte ndonjë avantazh të veçantë; dhe megjithatë përpara se sesioni i parë plenar të mbahej, ishte vendosur tashmë që punët e rëndësishme të Konferencës të kryheshin prej përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha (Britanisë së madhe, Francës, Italisë, Shteteve të Bashkuara dhe Japonisë). të njohura si Këshilli i të Dhjetëve. Për më tepër ky këshill mbulonte një volum të madh pune ku shpreheshin dhe merreshin këshillat e specialistëve si dhe krijonte komisionet e ekspertëve të cilët vepronin me shumicën e çështjeve territoriale. Në propozimin për themelimin e të parit prej këtyre komisioneve, Mr.Lloyd Xhorxh parashtroi vështirësi të mëdha për të vendosur “çështjen e kufijve në deklarata gjatë rrjedhës së bisedimeve, sado të qarta të ishin ato”. Ai më pas propozoi një komision me dy ekspertë nga secila prej katër Fuqive të studjonin problemin dhe bile sygjeroi t'i autorizonte ata që të konsultoheshin me përfaqësuesit e popujve të interesuar. Në alarm, Orlando atakoi propozimin për përdorimin e specialistëve. Por presidenti Uillon